AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**"Administrim Biznesi"**

**ofruar nga**

**Universiteti i Tiranës**


**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Ermira Qosja**
**Prof. Asoc. Dr. Edmond Kadiu**


**Janar / 2026**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**BACHELOR NË "ADMINISTRIM BIZNESI"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Menaxhimit & Departamenti i Marketingut dhe Turizmit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Administrim Biznesi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr. 359, datë 21.09.1991<br>UMAS nr. 110, datë 04.03.2022 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër Nr. 297, datë 20.07.2012, ndryshuar me Urdhër Nr. 355, datë 30.08.2013. |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuhë Shqipe / Angleze |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 (gjashtë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 2022-2023: PAE 110 - PAK 63<br>2023-2024: PAE 108 - PAK 76<br>2024-2025: PAE 102 - PAK 73 |
| 18 | Numri i studentëve: | 2022-2023: 420 studentë<br>2023-2024: 408 studentë<br>2024-2025: 416 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës është fakulteti që ka sjell një kontribut shumë të rëndësishëm në lëmin e studimeve ekonomike në Shqipëri, në të tre nivelet e studimit, bachelor, master dhe doktoraturë. Në këtë kuadër, Departamenti i Menaxhimit në bashkëpunim me Departamentin e Marketingut dhe Turizmit kanë konceptuar dhe hartuar Programin Bachelor në Administrim Biznes, që siç shprehen drejtuesit e tyre është një nga programet brand në tregun e Arsimit të Lartë në Shqipëri.

Programi BA në AB, si një nga programet më të rëndësishme të ofruara nga Departamenti i Menaxhimit & Departamenti i Marketingut dhe Turizmit, krijon një urë lidhëse me programet master të ofruara nga të dyja departamentet, por dhe i përgjigjet mjaft mirë dhe nevojave të tregut të punës. Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin e fundit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, udhëzimet që pasuan atë si dhe me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Zanafilla e programit në Administrim Biznes është në vitin 1993, duke reformuar programet e para '90 me ndryshimet politike dhe lirinë e tregut e mendimit. Programi fillimisht ishte 4 vjeçar dhe më pas me nënshkrimin nga Qeveria shqiptare të Kartës së Bolonjës u përshtat në bachelor tre vjeçar.

Prioritetet e programit BAAB janë në përputhje të plotë me ato të UT dhe kanë të bëjnë me: suksesin e studentëve dhe ekselencën akademike; avancim në studime, aktivitete krijuese dhe ndërtimin e karrierës. Programi BAAB synon të bëhet një faktor kyç në disiplinën e menaxhimit, sipërmarrjes dhe marketingut në vend dhe më gjerë. Një nga pikat e forta të programit është mësimdhënia nga një trupë akademike në përbërje të të cilit janë personalitete të disiplinës së menaxhimit dhe marketingut në vend, me një kontribut të vyer në formimin e shkollës së biznesit në Shqipëri.

Objektiva të rëndësishme të këtij programi bachelor janë dhe lidhja e studentëve me tregun e punës dhe ndërkombëtarizimi. Programi ndërlidh mjaft mirë ekselencën akademike me eksperiencën në industri dhe në raportet me industrinë të profesoratit, duke dhënë mundësinë që studentët të përgatiten për tregun e punës dhe një pjesë e tyre për hapin tjetër në karrierën akademike të tyre, studimet master.

*Dokumenti: RVB*

*Dokumenti 001.01: Mendimi Dekanit*

*Dokumenti 004: Plani strategjik i zhvillimit të Programit*

*Dokumenti 014: Dosje e plotë e programit të Studimit*

*Dokumenti 020: CV e stafit të DM dhe DMT*

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

ASCAL, bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof. Dr. Ermira Qosja** dhe **Prof. Asoc.Dr. Edmond** Kadiu. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatoria teknike e ASCAL, Znj. Rajna Lila.
Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznes", i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit & Departamenti i Marketingut dhe Turizmit të Fakultetit të Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm , si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL. Vizita në FEUT, u realizua në datën 15 dhe 16 Shtator 2025, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në FEUT, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit, Përgjegjësin e Departamentit të Marketingut e Turizmit, Zv. Dekania e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Qendrës së Karrierës dhe Alumnit, zv. dekanët të cilët mbulojnë: Ndërkombëtarizmin dhe Projektet; Kërkimin dhe Marrëdhëniet me Sipërmarrjen; si dhe me Sekretarinë mësimore.
GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit BAAB, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse.
Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Universiteti i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 17.11.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 138/16 Prot., datë 17.11.205. Universiteti i Tiranës njofton më datë 22.11.2025, nëpërmjet sistemit komentet mbi draft raportin. *Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

1. *Në lidhje me Standartin V.3, "FEUT në shërbim të informimit të studentëve, ka nevojë për më shumë qasje që bazohet në digjitalizim –* ***Konstatim i GVJ mbetet i pandryshuar****.*

   ***Përgjigja GVJ:*** E- student apo MS Teams janë platforma (aq më pak rrjetet sociale), janë vetëm zgjidhje pjesore, ndërkohe FEUT, si pjesa më e madhe e universiteteve në Shqipëri, kanë nevojë për një përqasje integruese në digjitalizim si ***Learning Management System do të shënonte një hap cilësor*** *(sistem i integruar)* kjo referuar jo vetëm përvojave ndërkombëtare, por dhe përvojave pozitive lokale. Digjitalizimi është dhe mbetet sfidë për cdo IAL dhe sistemin e arsimit në Shqipëri. GVJ e merr në konsideratë komentin e institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është ***hartuar në draft-raport ku mbetet i pandryshuar.***

2. *Në lidhje me Standartin V.6, "ka ende elementë për të përmirësuar veçanërisht në lidhje me trajtimin e ankesave dhe rrjetin alumni" –* ***Konstatimi GVJ mbetet i pandryshuar.***

   ***Përgjigja GVJ:*** Përtej gjithë rregulloreve, mbetemi të mendimit se ka vend për të përmirësuar trajtimin e ankesave të studentëve. Ndërkohë përgjigjia e dhënë nga FEUT për rrjetin alumni vetëm konfirmon rekomandimin e GVJ.

3. *Në lidhje me Standartin I.3, "GVJ gjatë vizitës në institucion dhe në takimin me studentët identifikoj dhe reflektoj në hartimin e RVJ-ës, nevojen për përmirësimin e procesit të realizimit të mësimit të gjuhës së huaj (Anglisht).* ***Konstatimi GVJ ka ndryshuar.***

   ***Përgjigja GVJ:*** *Ky konstatim nga koordinatorët e programit tashmë është i identifikuar dhe ata janë të angazhuar maksimalisht për ta adresuar për përmirësim. Ky fakt theksohet edhe në kthimin e përgjigjes së IAL_së.* GVJ e merr në konsiderat komentin e institucionit ku pranohet reflektimi mbi këtë gjetje dhe konstaton se ***draft-raporti në këtë pikë ndryshon.***

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Administrim Biznesi".**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Departamenti i Menaxhimit & Departamenti i Marketingut dhe Turizmit të Fakultetit Ekonomik në vizionin e tyre për programin BAAB synojnë të jenë lider në vend dhe rajon në përgatijen e studentëve në fushën e administrimit të biznesit, si dhe një pikë referimi për bizneset dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi.<br>Programi BAAB është në kohezion të plotë me një sërë dokumentash strategjike të Qeverisë shqiptare, si: Strategjia Kombëtare për Arsimin (2021- 2026); Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020) dhe Plani Kombëtar për Integrim Evropian (2020-2022).<br>Në takimin me drejtuesit e Fakultetit dhe drejtuesit e departamenteve u përforcua mendimi dhe vlerësimi që ky program synon investimin e duhur në kapitalin human, që do të kontribuojnë në rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovativ të sipërmarrjeve shqiptare, lidhjen universitet-industri dhe është një kontributor i rëndësishëm në garantimin e një arsimi të lartë cilësor.<br><br>*Dokumenti 004: Plani Strategjik i Programit*<br>*Dokumenti: RVB*<br>*Dokumenti 132: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020)*<br>*Dokumenti 130 Plani Kombëtar për integrim evropian (2020-2022)*<br>*Dokumenti 129: Strategjia Kombëtare për Arsimin (2021-2026)*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi BA në AB ka synuar të bëhet një faktor kyç në displinën e administrimit të biznesit në vend dhe më gjerë. Programi është krijuar nga eksperienca më e mirë e shkollës së biznesit në Shqipëri, duke harmonizuar ekselencën akademike të departamenteve respektive me nevojat e tregut të punës, por duke shërbyer dhe si një pedanë për të gjithë ata studentë që synojnë studimet e mëtejshme master dhe doktorale. |

| | |
|---|---|
| | Harmonizimi i teorisë me nevojat e tregut shqiptar është bërë e mundur përmes njohurisë dhe aftësisë së stafit akademik dhe kompetencës së tyre për t'u përshtatur me rastet studimore, projektet apo mikrotezat e kompanive shqiptare dhe të ekonomisë shqiptare.<br>Programi është në përputhje të plotë me vizionin e UT për të qenë model i arsimit të lartë publik në Shqipëri, këtë e dëshmojnë dhe numrat e studentëve të rregjistruar çdo vit. Përmes këtij programi, synohet që studentët të marrin njohuritë dhe të fitojnë aftësitë në të gjitha fushat që lidhen me administrimin e biznesit, por gjithashtu studentët të përqasen drejt parimeve etike dhe përgjegjësisë sociale, duke kontribuar kështu në zhvillimin e shoqërisë shqiptare.<br><br>*Dokumenti: RVB*<br>*Dokumenti 004: Plani Strategjik i Programit*<br>*Dokumenti: 001: Mendimi i Dekanit Bachelor Administrim Biznesi;*<br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit të Tiranës 2018;*<br>*Dokumenti: 005.1: Rregullore_UT 2022;*<br>*Dokumenti:007: Rregullore e programeve bachelor 2025;* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Në takimin me drejtuesit e FEUT dhe drejtuesit e departamenteve, përkatësisht të menaxhimit Prof.Asoc.Dr. L. dhe të marketingut e turizmit Prof. Asoc. Dr. M.A., përforcuam mendimin se programi BA në AB është në përputhje të plotë me vizionin e UT dhe vizionin e FEUT.<br>Programi BA në AB është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të (a) Statustit të UT (2018) që njeh Fakultetin e Ekonomisë si njësi kryesore dhe në përbërje të tij DM dhe DMT si njësitë bazë përgjegjëse për programin BA në AB;<br>Të bindur për avantazhet që programi dhe departamentet ofrojnë përkundrejt programeve të tjera BA të fakultetit, por dhe më gjerë, drejtuesit e FEUT dëshmuan dhe përmes një sërë statistikash që lidhen me aplikimet BA, studimin e tregut të punës, etj që ky program mbetet një brand i fakultet. "Shporta" e programeve bachelor që FEUT ofron i shërben nga njëra anë formimit të profesionistëve për tregun e punës lokal dhe global, por dhe nga ana tjetër formimit të mëtejshëm të studjuesve dhe kjo e mundësuar nga metodologjitë e përdorura në mësimdhënie që synojnë aftësimin logjik, të menduarit kritik dhe thellimin në analizë.<br>Programi BA në AB kontribuon në prioritetin e UT lidhur me përforcimin e komponentit të ndikimit në shoqëri, kryesisht përmes: përfshirjes së biznesit në zhvillimin e konkurseve të sipërmarrjes dhe inovacionit, ofrimit të praktikave të |

| | |
|---|---|
| | studentëve, vizitave studimore apo organizimin e leksioneve të hapura, pjesëmarrjen në panaire pune etj.<br><br>*Dokumenti: 001: Mendimi i Dekanit Bachelor Administrim Biznesi;*<br>*Dokumenti:002 Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti: 005: Rregullore e UT 2010 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti:005.1: Rregullore_UT 2022;*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022;*<br>*Dokumenti:007: Rregullore e programeve bachelor 2025*<br>*Dokumenti:012.3: Raport Dita e Karrieres 2025;*<br>*Dokumenti: 034.1: Projektet FE 2024 Kombetare;*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit* |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Gjatë shqyrtimit të Dosjes së plotë të programit të studimit, Silabuseve të lëndëve dhe Planit Strategjik të Programit, evidentohet që programi Bachelor në "Administrim Biznesi" është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri për specialistë me aftësi menaxheriale, për të punuar në SME dhe ndërmarrjet e mëdha shqiptare, në organizatat jofitimprurëse dhe në organizatat e huaja që operojnë në Shqipëri dhe më gjerë.<br>Gjatë takimit me stafin akademik të departamenteve të menaxhimit & marketingut e turizmit u diskutua sesi ata përcjellin njohuritë që vijnë përmes teksteve të huaja dhe realitetit shqiptar përmes rasteve studimore, projekteve, të ftuarve në auditor dhe vizitave në biznese.<br>Në FEUT, në vitin akademik 2024-2025 janë angazhuar 168 pedagogë si personel akademik efektiv, 221 pedagogë të ftuar (me kontratë) pranë njësive bazë dhe mbi 30 pedagogë nga njëra tjera në fakultete me të cilat FEUT bashkëpunon për lëndët ekstra kurrikulare si gjuhë e huaj, e drejtë biznesi apo edukim fizik.<br>Duhet theksuar që stafi akademik në FEUT ka nivel të lartë të përgatitjes profesionale në përbërje të tij 47% pedagogë mbajnë titullin Profesor ose Profesor i Asociuar, ndërsa pjesa tjetër janë me gradën doktor (24%) ose doktorantë në process, Në lidhje me stafin e departamenteve përgjegjës për programin Bachelor në "Administrim Biznesi", 40% e stafit efektiv kanë gradën Prof. Dr ose Prof. Asoc. Dr dhe 60% Dr ose Dr në proces.<br><br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit*<br>*Dokumenti 020: CV e stafit akademik të programit të studimit Dept Manaxhimit;*<br>*Dokumenti 020.1: CV e stafit akademik të programit amit të studimit Dept Marketing Turizmit;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 023: Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse;* |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi Bachelor në "Administrim Biznesi" është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të (a) Statustit të UT (2018) që njeh Fakultetin e Ekonomisë si njësi kryesore dhe në përbërje të tij DM dhe DMT si njësitë bazë përgjegjëse për programin BA në AB;<br>BA në AB i përket grupit 041 Business and administration dhe në mënyrë specifike programit me kod 0413 Management and administragion sipas standardeve ndërkombëtare të klasifikimit të fushave të studimit<br><br>*Dokumenti:002 Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti: 005_Rregullore e UT 2010 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë eprogramit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti 031: Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson që programi i studimit Bachelor në "Administrim Biznesi", është hartuar dhe zbatohet në përputhje të plotë me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe udhëzimet që rrjedhin prej tij, është në mbështetje të strategjive kryesore të zhvillimit ekonomik dhe integrimit në BE të vendit, si dhe në respekt të Statutit dhe rregulloreve institucionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e | Programi BA në AB është pjesë e ofertës akademike të FEUT, që për shkak të veçorive të programit, strukturës organizative të fakultetit dhe aspekteve ligjore që rrjedhin nga Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, koordinohet nga dy departamente, përkatësisht Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Marketingut dhe Turizmit. Detyrat, përgjegjësitë dhe modalitetet e koordinimit në të gjitha nivelet për ecurinë e programit BA në AB përcaktohen nga një sërë dokumentesh: |

| | |
|---|---|
| personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | si Statuti i UT, rregulloret në nivel universiteti, fakulteti, departamenti, programi studimi, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, dhe hierarkinë institucionale të universitetit. Në nivel Universiteti, aspekti administrativ dhe i standardeve mbulohet nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimi i Cilësisë, Njësitë bazë kanë përgjegjësinë kryesore të hartimit dhe ofrimit të programit të studimit, të cilën e funksionalizojnë përmes përcaktimit të koordinatorëve të programit për çdo department, që në rastin në fjalë për shkak të peshës që ka programi janë dy drejtuesit e departamenteve.<br><br>Fakulteti dhe departamentet në mënyrë të vazhdueshme hartojnë raporte për analizën e ecurise së programeve të studimit dhe departamenteve në lidhje me mësimdhënien, kërkimin, ndërkombëtarizimin, projektet; stafin; të dhënat e gjurmimit; studentët dhe infrastrukturën. Po këtij qëllimi i shërbejnë mbledhjet periodike të departamenteve, të dekanatit dhe midis departamenteve të Menaxhimit dhe Marketingut e Turizmit për të diskutuar problematika të ndryshme lidhur me ecurinë e programit, përditësimeve dhe nevojës për qasje të reja në mësimdhënie e ndërveprim me studentët.<br><br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 006: Rregullore per organizimin dhe funksionimin e Departamentit te Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 006.1: Rregullore Njësia Bazë DMT 2022;*<br>*Dokumenti 101.1: Raporti Raporti vjetor FEUT 2021-2022;*<br>*Dokumenti 101.2: Raporti vjetor FEUT 2022-2023;*<br>*Dokumenti 101.3: Raporti vjetor FEUT 2023-2024;*<br>*Dokumenti 035: Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve;*<br>*Dokumenti 036-1.2.3: Vendime për emërimin e Koordinatorit të programit për secilin departament* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë | Eksperienca dhe tradita që Fakulteti Ekonomik ka brenda UT në shumë vite, krijon oportunitete për bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit. Nëse do t'i referoheshim dokumentit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të UT, evidentohet që shumë prej marrëveshjeve janë të fokusuara në fushat që FEUT mbulon duke përbërë një hapësirë shumë të frytshme për punën shkencore, projektet ndërkombëtare dhe ndërkombëtarizimin e këtij fakulteti. |

| | |
|---|---|
| vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Gjithashtu, në Raportiet vjetore të FEUT vihet re që stafet e Departamentit të Menaxhimit&Departammentit të Marketingut dhe Turizmit ka një përfshirje të konsiderueshme në mobilitete, projekte lokale dhe ndërkombëtare, duke përbërë një avantazh të rëndësishëm të tij brenda UT dhe në mjedisin e Arsimit të Lartë në Shqipëri.<br><br>FEUT dhe Departamentet kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi dhe me organizata publike dhe kompani private dhe sic shihet në Tabelën Përmbledhëse të institucioneve bashkëpunuese me BA në AB dhe praktikën profesionale, roli i departamenteve është i rëndëssihëm.<br><br>***GVJ evidenton që Departamenti i Menaxhimit & Departamenti i Marketingut dhe Turizmit kanë mundësi dhe duhet të jetëzojnë më shumë bashkëpunime me industrinë. Duhen ndërtuar skemat formale të bashkëpunimit me industrinë dhe duhen gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikat/ intershipet e tyre, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe startupeve të reja, duke e shndërruar FEUT në një HUB inovacioni.***<br><br>Gjatë vizitës në FEUT, ekpertët u njohën dhe zhvilluan takime me zvdekanët. Në nivel fakulteti, në strukturën e dekanatit janë katër zvdekanë, ku një nga prej tyre ka fokus ndërkombëtarizimin dhe një tjetër marrëdhënien me sipërmarrjen. Një strukturë e tillë dëshmon për seriozitetin dhe fokusin në bashkëpunime të FEUT.<br><br>*Dokumenti 034: Marrëveshjet Erasmus + UT dhe me IAL të tjera;*<br>*Dokumenti 034.1: Projektet FE 2024 Kombëtare;*<br>*Dokumenti 034.1.2: Listë Aplikim Projekte Brenda vendii 2024-2025;*<br>*Dokumenti 034.2: Projekte ne Implementim 2024-2025;*<br>*Dokumenti 034.2.2: Listë Aplikim Projekteve Ndërkombëtare 2024-20*<br>*Dokumenti 035: Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në fumksion të realizimit të programit të studimeve*<br>*Dokumenti 101.1: Raporti Raporti vjetor FEUT 2021-2022;*<br>*Dokumenti 101.2: Raporti vjetor FEUT 2022-2023;*<br>*Dokumenti 101.3: Raporti vjetor FEUT 2023-2024;*<br>*Dokumenti 038.1: Analizë vjetore e Departamentit te Marketing Turizem 2019-2022;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 038.2: Analizë vjetore e Departamentit te Menaxhimit 2020-2021; Dokumenti 038.3: Analiza Vjetore Departamenti i Menaxhimit 2021-2022* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | FEUT për shkak të traditës dhe cilësisë së studentëve, është një pikë referimi për institucionet publike, organizatat e rëndësishme në vend, kompanitë e mëdha të biznesit, sistemin bankar etj. Për këto arsye, po dhe për faktin që një pjesë e pedagogëve gëzojnë reputacion në jetën ekonomike dhe sociale në vend, marrëveshjet formale dhe lista e institucioneve bashkëpunuese mund të jetë më e zgjeruar.<br>Gjatë takimeve në FEUT, pedagogët u shprehën, por dhe studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karrierën e tyre.<br>Praktika mësimore si në të gjitha universitetet e vendit ka nevojë të strukturohet dhe formalizohet më shumë, dhe kjo sigurisht kërkon proaktivitet të dy departamenteve, nisur dhe nga numri i madh i studentëve.<br>Me ndryshimet infrastrukturore, Qendra e Karrierës ka një vendodhje të dukshme në tërësinë e zyrave në shërbim të studentit në hollin e FEUT, zhvillon një sërë aktivtetesh, ka bërë shumë publikime në faqen e internetit, për të konceptuar dhe ngritur një sistem funksional të bashkëpunimit industri – universitet, siç evidentohet dhe në Planin Strategjik të Programit BA në AB.<br><br>*Dokumenti 034: Marrëveshjet Erasmus + UT dhe me IAL të tjera;*<br>*Dokumenti 034.1: Projektet FE 2024 Kombetare;*<br>*Dokumenti 034.1.2: Listë Aplikim Projekte Brenda vendii 2024-2025;*<br>*Dokumenti 034.2: Projekte ne Implementim nderkombëtare 2024-2025;*<br>*Dokumenti 034.2.2: Liste Aplikim Projekte kte Nderkombetare Nderkombetare 2024-20 2025*<br>*Dokumenti 035: Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në fumksion të realizimit të programit të studimeve*<br>*Dokumenti 101.1: Raporti Raporti vjetor FEUT 2021-2022;*<br>*Dokumenti 101.2: Raporti vjetor FEUT 2022-2023;*<br>*Dokumenti 101.3: Raporti vjetor FEUT 2023-2024;*<br>*Dokumenti 038.1: Analizë vjetore e Departamentit të Marketing Turizem 2019-2022;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 038.2: Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit 2020-2021; Dokumenti 038.3: Analiza Vjetore Departamenti i Menaxhimit 2021-2022*<br>*Dokumenti 004 Plani strategjik për zhvillimin e programit*<br>*Dokumenti 012.3 Raport Dita e Karrierës 2025*<br>*Dokumenti 012.6/012.7. Raporte Panairi i Karrierës:* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Në kulturën institucionale të FEUT, bazuar në info që vjen përmes raporteve të departamenteve, në këtë program studimi përkatësisht të DM dhe DMT, hartohen Raportin Vjetore të FEUT ku një element i veçantë i trajtimit janë marrëveshjet e bashkëpunimit. Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Marketingut dhe Turizmit në Analizën Vjetore të Punës së tyre, i kushtojnë një trajtim të veçantë angazhimit të stafit në marrëveshjet dhe projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunimit me institucione në nivel lokal dhe kombëtar.<br>Natyrisht, në raportet evidentohet nevoja për një angazhim më serioz dhe vazhdimsi në bashkëpunimin me industrinë e fakultetit, duke mos e lënë këtë proces vetëm në vullnetin e mirë të një apo disa pedagogëve.<br><br>*Dokumenti 035: Raporti i fundit periodik analitik i përfitimevg nga marrëveshjet e bashkëpunimit në fumksion të realizimit të programit la studimeve*<br>*Dokumenti 101.1: Raporti Raporti vjetor FEUT 2021-2022;*<br>*Dokumenti 101.2: Raporti vjetor FEUT 2022-2023;*<br>*Dokumenti 101.3: Raporti vjetor FEUT 2023-2024;*<br>*Dokumenti 038.1: Analizë vjetore e Departamentit te Marketing Turizem 2019-2022;*<br>*Dokumenti 038.2: Analizë vjetore e Departamentit te Menaxhimit 2020-2021; Dokumenti 038.3: Analiza Vjetore Departamenti i Menaxhimit 2021-2022*<br>*Dokumenti 012.3: Raport Dita e Karrieres 2025*<br>*Dokumenti 012.6/012.7. Raporte Panairi Karrierës* |
| **Konkluzione** | *FEUT, DM dhe DMT si pjesë e qenësishme dhe proaktive e UT, janë pjesë e marrëveshjeve të shumta institucionale brenda dhe jashtë vendit, duke synuar të forcojnë kërkimin shkencor, ndërkombëtarizimin dhe punën me projekte në kuadër të misionit të universiteteve.*<br>***Departamentet respektive kanë mundësi dhe mund të jetëzojnë më shumë bashkëpunime me industrinë, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe startupeve të reja, duke e shndërruar FEUT në një HUB inovacioni.*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi Bachelor në "Administrim Biznesi" që nga momenti i hartimit të tij në vitin 1993 deri më sot, është përshtatur në kohë në përputhje me ndryshimet ligjore. Aktualisht, struktura e programit është në përputhje me Ligjin 80/2015 si dhe VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018, azhornuar më tej me VKM Nr. 879, dt.18.12.2019.<br>Qëllimi i programit Bachelor në "Administrim Biznesi" është që studentët të fitojnë aftësitë profesionale dhe udhëheqëse që do ju shërbejnë vetë atyre, bizneseve dhe sigurisht edhe komunitetit ku ata do të operojnë. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit:<br>-Të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë manaxhimi dhe marketingu të bizneseve të vogla e të mesme, të sektorit publik dhe privat.<br>- Të kenë njohuri rreth perspektivave sipërmarrëse.<br>- Studentët të jenë të aftë të identifikojnë, vlerësojnë dhe formësojnë mundësitë sipërmarrëse në një larmi kontekstesh në të cilat vepron biznesi. Të kenë një bazë të qëndrueshme njohurish formuese në fushën e manaxhimit dhe marketingut, financës dhe ekonomisë, duke demonstruar profesionalizëm në fushën e manaxhimit dhe marketingut dhe në realizimin e studimeve më të avancuara në këto fusha.<br>- Të demonstrojnë një komunikim profesional dhe efektiv, aftësi bashkëpunuese dhe udhëheqëse në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të grupit në të cilin do të jenë të angazhua<br>Mbështetur në Dosjen e Plotë të Programit të Studimit, BA në AB është organizuar si më poshtë vijon:<br>- 3 vite akademike/6 semestra; |

| | |
|---|---|
| | - numri i moduleve 32;<br>- ngarkesa mësimore 4500 orë: 1922 orë në auditor; 2578 orë jashtë tij;<br>- ngarkesa mësimore javore 19-22 orë;<br>- forma e mësimdhënies:<br>Leksione/seminare/ushtrime/projekte/detyra kursi.<br>Silabuset e lëndëve janë formuluar në përputhje me udhëzimet dhe përmbajnë elementët e koncepteve bazë/rezulatet e të nxënit/temat/ kodin e etikës/ orët në auditor leksion/seminar/format e kontrollit të dijes/frekuentimin/literaturën. Silabuset janë formuluar në shqip dhe anglisht.<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 19: Syllabuser e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Ky program studimi ka formën dhe strukturën e një programi tradicional bachelor në administrim biznesi. Lëndët që e përbëjnë programin mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me botën e biznesit dhe funksionet që zhvillohen brenda tij.<br>Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të: manaxhimit, marketingut, të financës, të kontabilitetit, të informatikës dhe të statistikës, të mikro dhe makroekonomisë, të legjislacionit tregtar, etj.<br>Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018 përsa i përket përmbajtjes sipas kategorive: Lëndë bazë, Lëndë karakterizuese, Lëndë plotësuese. Lëndë ndërdisplinore dhe Detyrime përmbyllëse.<br><br>*<u>GVJ sugjeron</u> nevojën që pas akreditimit të shihet mundësia për integrimin e lëndëve si Psikologjia, Sjellja konsumatore, Media sociale dhe Marketingu digjital, Sipërmarrje dhe Startup, si dhe shumë e rëndësishme impaktimi programit me AI dhe teknologji digjitale dhe brenda silabuseve të lëndëve.*<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti: RVB* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Mbështetur në VKM 41/2018 dhe në Rregulloren e Programit të studimit BA në AB, programi është organizuar si më poshtë:<br><br>- Kategoria A – Lëndë Bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (6 lëndë me 37 ECTS në total,ose 20 %,) *standardi (13-20%)*<br>- Kategoria B – Lëndë Karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, (16 lëndë me 94 kredite në total, ose 52%), *standardi (50-55%)*<br>- Kategoria C–Lëndë ndërdisiplinore/integruese– (5 lëndë me 25 ECTS ose 14 %), *standardi (12-15%)*<br>- Kategoria D – Lëndë plotësuese–4 lëndë dhe praktika profesionale, 18 ECTS ose 10%, *standardi (10-15%)*<br>- Kategoria E - Detyrimet përmbyllëse, 6 ECTS ose 3 %, *standardi (3-5%)*<br><br>Studentët e programit Bachelor në Administrim Biznesi marrin 10 lëndë gjatë vitit të parë-gjithsej 58 ECTS, 10 lëndë në vitin e dytë- gjithsej 58 ECTS, dhe në vitin e tretë 10 lëndë, plus Praktikën Mësimore dhe Projektin e Diplomës- gjithsej 64 ECTS.<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë eprogramit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 19: Syllabuser e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Praktika profesionale është 3 ECTS në programin e studimit BA në AB. Gjatë vizitës në institucion, diskutuam për mënyrën si organizohet praktika. Organizimi praktikës mbështetet në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në tërësinë e dokumentave të praktikës, por Departamentet do të duhet të hartojë Rregulloren e Praktikës Mësimore.<br>Në lidhje me Punimin e diplomës, DM ka hartuar një udhërrëfyes metodologjik që suporton studentët, krahas ndihmës që jep pedagogu udhëheqës gjatë gjithë kohës së realizimit deri në mbrojtje. Në funksion të udhëheqjes, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të cilat zhvillohen në mënyrë hibride. |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 112: Miratimi Praktika Mësimore Bachelor;*<br>*Dokumenti 112.1: Formular Vlerësimi Studenti Praktika Mësimore Bachelor; Dokumenti 112.2: Formular Vlerësimi Studenti Praktikant Pedagogu Udheheqës Bachelor;*<br>*Dokumenti 112.3: Formular Raporti Përfundimtar Praktika Mësimore Bachelor;*<br>*Dokumenti 112.4: Formular Vlerësimi - Temë Diplome për Ciklin e Parë Bachelor;*<br>*Dokumenti 114: Udhëzuesi i temës së diplomës 2022;*<br>*Dokumenti 015.1: Modeli i Diplomes Shqip Administrim Biznesi;*<br>*Dokumenti 015.2: Modeli i Diplomes Administrim Biznesi-Anglisht;*<br>*Dokumenti 055: Komunikimi me student ne Teams per mbikqyrje* |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | **N / A** |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Programi BA në AB i FEUT është programi i parë i këtij fushe në shkollat e larta në Shqipëri. Pjesa më e madhe e shkollave shqiptare të biznesit janë mbështetur në të, dhe në gjithë teknologjinë e hartimit të programit mësimor.<br>Ky program ka qenë dhe mbetet një model i zhvillimit të programeve bachelor në fushën e administrimit të biznesit apo menaxhimit të biznesit, veçanërisht për universitetet publike. |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Në përputhje me legjislacionin e Arsimit të Lartë, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës me urdhër nr. 297, datë 20.07.2012 i ka akorduar Programit BA në AB kodin 000617, ndërkohë lëndët e programit janë të kodifikuara sipas VKM NR.41, datë 24.01.2018<br><br>*Dokumenti 031: Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit;*<br>*Dokumenti 031.1: Kodet e Programeve 2012* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | **N / A** |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson që organizimi i programit bëhet në përputhje me ligjin. Në lidhje me përmbajtjen e programit dhe të lëndëve departamenti vlerëson vit pas viti veprimtarinë e tij në cdo aspekt dhe bën benchmarking me praktikat më të mira brenda vendit dhe europiane.*<br>*Pas akreditimit të programit sugjerojm që mund të shihet vendosja në Planin Mësimor e lëndëve si Psikologjia, Sjellja konsumatore, Media sociale dhe Marketingu digjital, Sipërmarrje dhe Startup, si dhe shumë e rëndësishme impaktimi programit me AI dhe teknologji digjitale dhe brenda silabuseve të lëndëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Fakulteti i Ekonomisë i UT, si njësia kryesorë përgjegjëse për programin e studimit BA në AB, përbëhet nga 6 njësi bazë, emërtimi dhe stafi i të cilëve jepet në tabelën e mëposhtme (viti 2024-2025):<br><br>(see table below)<br><br>Departamentet përgjegjëse për këtë program studimi janë Departamenti i Menaxhimt dhe Departamenti i Marketingut dhe |

| **Emërtimi Departamentit** | **Stafi me kohë të plotë** |
|---|---|
| Departamenti i Ekonomiksit | 36 |
| Departamenti i Financës | 29 |
| Departamenti i Kontabilitetit | 22 |
| Departamenti i Marketing-Turizmit | 18 |
| Departamenti i Manaxhimit | 29 |
| Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar | 34 |

| | |
|---|---|
| | Turizmit, të cilët në përbërje të tyre kanë staf me kohë të plotë dhe të pjeshme si më poshtë (viti akademik 2024-2025): |

| Kualifikimi 2024-2025 | Dep. Menaxhimit PAE | PAK | Dep. Marketingut dhe Turizmit PAE | PAK |
|---|---|---|---|---|
| Prof.Dr | 4 | 1 | 4 | 1 |
| Prof.Asoc | 7 | 2 | 4 | 1 |
| Dr/PhD | 7 | 8 | 6 | 4 |
| Dr në proces | 11 | 12 | 4 | 15 |
| Msc | 0 | 25 | 0 | 15 |
| **Gjithsej** | **29** | **48** | **18** | **36** |

| Kualifikimi 2023-2024 | Dep. Menaxhimit PAE | PAK | Dep. Marketingut dhe Turizmit PAE | PAK |
|---|---|---|---|---|
| Prof.Dr | 5 | 0 | 5 | 1 |
| Prof.Asoc | 7 | 2 | 4 | 0 |
| Dr/PhD | 8 | 8 | 6 | 3 |
| Dr në proces | 11 | 0 | 5 | 0 |
| Msc | 0 | 35 | 0 | 22 |
| **Gjithsej** | **31** | **45** | **20** | **26** |

| Kualifikimi 2022-2023 | Dep. Menaxhimit PAE | PAK | Dep. Marketingut dhe Turizmit PAE | PAK |
|---|---|---|---|---|
| Prof.Dr | 6 | 0 | 5 | 1 |
| Prof.Asoc | 6 | 2 | 4 | 0 |
| Dr/PhD | 9 | 8 | 6 | 3 |
| Dr në proces | 0 | 0 | 5 | 0 |
| Msc | 10 | 20 | 0 | 22 |
| **Gjithsej** | **31** | **47** | **20** | **26** |

Stafi i departamenteve përgjegjës për programin, por dhe i departamenteve të tjera të FEUT ka formimin akademik dhe shkencor për të realizuar një proces akademik ekselent, në përputhje

| | |
|---|---|
| | me zhvillimet bashkëkohore në fushat përkatëse të programit BA në AB.<br><br>*Dokumenti 144, 144.1; 144.2: Burimet njerëzore FEUT sipas viteve*<br>*Dokumenti 026: Rregullore Njësia Bazë DM 2022;*<br>*Dokumenti 006.1: Rregullore Njësia Bazë DMT 2022;*<br>*Dokumenti 020: CV e stafit akademik të programit të studimit Dept Manaxhimit; Dokumenti 020.1: CV e stafit akademik të programit të studimit Dept Marketing Turizmit;*<br>*Dokumenti 043: Puna kerkimore shkencore 2018-2022 DMT;*<br>*Dokumenti 043.1: Aktivitet Shkencor 2021-2022;*<br>*Dokumenti 043.1.2_Kerkimi Shkencor FEUT 2021-2022;*<br>*Dokumenti 043.2 Aktivitet shkencor 2022- 2023;*<br>*Dokumenti 043.2.2: Kerkimi Shkencor 2022-2023;*<br>*Dokumenti 043.3: Aktivitet shkencor 2023- 2024;*<br>*Dokumenti 043.3.2: Kerkimi Shkencor 2023-2024;*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022;*<br>*Dokumenti 092: Stafi i Departamentit te Manaxhimit;*<br>*Dokumenti 092.1: Stafi i Departamentit te Marketing-Turizmit;* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Në përputhje me strukturën e organizmit të Fakultetit, DM dhe DMT përgjegjës për programin e studimit BA në AB, angazhojnë respektivisht nga një (1) personel ndihmës akademik në mbështetje të mbarëvajtjes administrative e të veprimtarisë mësimore. Personeli ndihmës mbështet drejtuesin e departamentit në menaxhimin akademik, raportimet e ndryshme, ndërveprimin për çështje akademike me studentët.<br>Në lidhje me praktikat mësimore, vijojnë të zhvillohen nga studentët në institucione/biznese, për shkak të numrit të studentëve në vit të tretë, duket pak e vështirë për t'u menaxhuar. Në këtë proces, studentët mbikqyren dhe vlerësohen nga stafi akademik me kohë të plotë i departamenteve. Çështja e efektivitetit të praktikave mësimore, mbetet e diskutueshme në të gjitha shkollat e larta shqiptare.<br><br>*Dokumenti 023: Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse;*<br>*Dokumenti 141: Hapat e nevojshme mbi zgjedhjen e pedagogut udhëheqës dhe proceset që lidhen me praktikën dhe diplomën* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në | Bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Rregullorja e UT, Rregullorja e departamentit dhe Rregullorja e Programit të Studimit, parashikojnë përcaktimin e koordinatorit të programit të studimit. Për shkak të varësisë së programit BA në AB nga dy departamente, me vendim të Dekanit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | drejtuesit e DM dhe DMT janë përcaktuar si bashkë – koordinatorë të programit.<br><br>*Dokumenti 036.1: Vendim per emerimin e koordinatorit te studenteve;*<br>*Dokumenti 036.4: Caktohen Kordinatorët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore UT 2022;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 006: Rregullore per organizimin dhe funksionimin e Departamentit te Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 006.1: Rregullore Njësia Bazë DMT 2022;* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson që dy departamentet përgjegjëse për programin bachelor në administrim biznesi, plotësojnë më së miri, kriteret ligjore dhe të cilësisë së stafit akademik. Numri i pedagogëve të kategorisë profesor të angazhuar në program.*<br>*CV e stafit të programit dhe departamentit, dhe angazhimi i tyre në veprimtari të ndryshme, është treguesi më i mirë i seriozitetit dhe suksesit të programit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Programi BA në AB i ofruar nga FE, është shfaqur herët në ofertën akademike të UT duke reflektuar në kohë përshtatjet me: ndryshimet ligjore; programet e shkollave europiane; zhvillimin ekonomik; si dhe nevojat që vijnë nga tregu i punës e industria. Drejtuesit e fakultetit dhe të departamenteve përgjegjës për programin e studimit shprehen se programi ka reflektuar në kohë formimin dhe përvojën e disa nga pedagogëve më të mirë të menaxhimit e biznesit në Shqipëri, duke krijuar në këtë mënyrë modelin e shkollës së parë të biznesit në vend.<br><br>Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimit me stafin akademik të programit, GVJ u dakordësua me ta që sot dinamikat e punësimit të studentëve janë të tilla që ata synojnë formim dhe aftësim në nivel lokal dhe global dhe përmbajtja e programit duhet të përshtatet me trendet e reja teknologjike dhe sociale. |

| | |
|---|---|
| | Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit, në përmbajtjen e silabuseve, në mënyrën e konceptimit të orës së mësimit, kontrollit të njohurive, të ftuarit në leksion, evidentohet që pedagogët përpiqen pikërisht të bashkojnë nevojat lokale me ato globale, por mbetet ende për t'u bërë në drejtim të metodave më proaktive të mësimdhënies dhe mbi të gjitha impaktimit me AI dhe teknologjitë digjitale të përmbajtjes së programit dhe pikërisht për këtë është punuar në Strategjinë e zhvillimit të këtij programi studimi për periudhën 2025-2030. DM dhe DMT pas kaq vitesh eksperiencë në programin BA në AB, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, kanë hartuar të gjithë sistemin rregullator dhe menaxhues të këtij programi studimi, përkatësisht:<br>- Rregulloren e programit të studimit,<br>- Planin dhe programin mësimor;<br>- Silabuset në gjuhën shqipe dhe angleze<br>- CV-të e personelit akademik<br>Në faqen zyrtare në internet të FEUT, studentët njihen mbi dokumentat kryesore, planet dhe programet mësimore dhe shumë informacione të tjera në funksion të rregjistrimeve dhe kalendarit akademik.<br><br>*Dokumenti 004: Plani strategjik për zhvillimin e programit (në nivel akademik, financiar, burimesh njerëzore*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve Bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 076.2: Plani mesimor 2022-2023 Anglisht;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);*<br>*Dokumenti 020: CV e stafit akademik të programit të studimit të Dept Manaxhimit; Dokumenti 020.1: CV e stafit akademik të programit të studimit Dept Marketing dhe Turizmit;* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Programi i Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Marketingut dhe Turizmit është i strukturuar në 3 vite studimi, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS.<br>Ky program studimi është në përputhje me Sistemin e Bolonjës. Programi dhe Plani mësimor i programit të studimit BA në AB ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UT dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim.<br>Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi |

| | |
|---|---|
| | dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët janë kryesisht me 6 ECTS, 4 lëndë me 7 ECTS, disa lëndë të tjera me 5, 4 apo 3 ECTS. Ndërkohë raporti leksione/seminare lëviz në funksion të tiplogjisë së lëndës. Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite.<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve Bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 076: Plani mësimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mësimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 076.2: Plani mësimor 2022-2023 Anglisht;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Kriteret e pranimit të studentëve në Programin BA në AB janë kriteret ligjore të përcaktuara nga MAS dhe udhëzimet që dalin për rregjistrimet në universitete çdo vit akademik.<br><br>Në Rregulloren institucionale dhe të programeve të studimit bachelor, qartësohen kushtet dhe procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit. Rregullorja parashikon dhe pranimin e kandidatëve nga trojet dhe me status të veçantë si dhe ata që ndjekin një program të dytë studimi.<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve Bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT*<br>*Dokumenti: 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite. Mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB, programi BA në AB është organizuar si më poshtë vijon: 3 vite akademike/6 semestra; kredite për 3 vite akademik respektivisht 180 ects; numri i moduleve 32, përfshirë praktikën dhe diplomën; ngarkesa mësimore 4500 orë: 1922 orë në auditor; 2578 orë jashtë tij, ngarkesa mësimore javore rreth 19-22 orë në javë; forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi.<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve Bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 076.2: Plani mesimor 2022-2023 Anglisht;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Programi në kohë ka pësuar ndryshime dhe përmirësime në përputhje me ndryshimet ligjore, dinamikat e tregut dhe përvojën e vyer të departamenteve përgjegjëse.<br>Në fillim të çdo viti akademik, në përputhje me rregulloret e brendshme, syllabuset përditësohet nga pedagogët e lëndës ë drejtim të përmbajtjes, metodologjisë apo literaturën. Syllabuset në shqip dhe anglisht, hartohen nga lektorët e lëndëve dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit.<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve Bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT-2022*<br>*Dokumenti: 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti 076.3: Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara, syllabuset.* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson që programi Bachelor në AB është strukturuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, është detajuar dhe organizuar në përputhje me VKM 41/2018 dhe plotëson më së miri objektivat formuese të një programi Bachelor në Administrim Biznesi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Mbështetur në VKM 41/2018 dhe në Rregulloren e Programit të studimit, programi BA në AB është hartuar që nga njëra anë të japë njohuri bazë dhe nga ana tjetër të krijojë aftësi dhe qëndrime të caktuara në fushën e administrim biznesit, duke i mundësuar studentëve formimin e duhur për punësim dhe studime të mëtejshme.<br><br>Silabuset e lëndëve janë formuluar në përputhje me udhëzimet dhe përmbajnë elementët e koncepteve bazë/rezulatet e të nxënit/temat/ kodin e etikës/ orët në auditor leksion/seminar/format e kontrollit të dijes/frekuentimin/literaturën. Silabuset janë formuluar në shqip dhe anglisht. |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 19: Syllabuser e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);* |
| **Kriteri 2.**<br>Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Marketigut e Turizmit në FEUT është i strukturuar në 3 vite studime, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 58 kredite në vitin e parë dhe të dytë dhe 64 kredite në vitin e tretë.<br>Programi dhe Plani mësimor i programit të studimit BA në AB ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UT dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim.<br>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Në vitin e parë, studentëve ofrohen lëndët që japin njohuri mbi parime të funksionimit të ekonomisë dhe biznesit si dhe disa lëndë formuese të pëgjithshme (gjuhët e huaja, sociologji apo shkrim akademik).<br>Viti i dytë nga njëra anë ofron matematikën e statistikën dhe nga ana tjetër synon të forcojë njohuritë dhe aftësitë mbi rolin e biznesit në ekonomi, kuantifikimin e vlerës të shtuar nga biznesi, rolin e informatikës, si dhe të aftësojë studentët në fushën e të drejtës dhe të etikës. Në përfundim të këtij viti, studentët kanë ndërtuar fazat e njohurisë në fushën e ekonomisë, informatikës e statistikës, financës e kontabilitetit dhe manaxhimit e marketingut.<br>Viti i tretë i jep mundësi studentit të thellohet në fusha si financa, operacionet, burime njerëzore, marketingu. Praktika mësimore dhe diploma si veprimtari përmbyllëse synojnë që të nxisin edhe reflektimin dhe integrimin e lëndëve me qëllim që |

| | |
|---|---|
| | studenti të rrisë aftësitë analitike dhe konceptuale si dhe të marrë vendimet e duhura për hapin e radhës. Në RVB gjejmë të shprehur, që programi AB në AB i FEUT, ka ngjashmëri me programin AB të Departamentit të Shkencave të Administrimit të UNIBO.<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);*<br>*Dokumenti: 145.2. Program BA në AB nga University of Bologna;*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të ti*<br>*Dokumenti: RVB* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Mbështetur në Rregulloren e Programit BA në AB, silabuset e lëndëve, evidentojmë që lëndët dhe përmbajtja e tyre, shërbejnë për të krijuar njohurinë dhe aftësuar studentëve në fushat bazë të biznesit, u krijon mundësi që të përsosin të menduarin kritik dhe instrumenta të analizës, duke u përqasur si në funksion të nevojave që tregu lokal apo ndërkombëtar të punës. Në nivel lënde, raporti teori-praktikë është minimalisht 50%-50% pasi leksionet dhe seminaret kanë pothuajse të njëjtën ngarkesë. Ky program është i ngjashëm me programin e UNIBO. Ky program krijon një bazë të domosdoshme për studime të tjera e thellime në fusha më specifike të biznesit.<br><br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuser e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);*<br>*Dokumenti: 145.2. Program BA në AB nga University of Bologna; 014_Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të ti*<br>*Dokumenti: RVB* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve | Silabuset në pjesën më të madhe respektojnë plotësisht VKM41/2018, duke pasqyruar rubrikat me vendimet, por duke |

| | |
|---|---|
| /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | reflektuar dhe veçoritë e cdo departamenti. Silabuset, përmirësohen vit pas viti, kjo reflektohet dhe në literaturën e përdorur.<br><br>*Dokumenti 019: Syllabuser e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Qëllimi dhe objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje të plotë me qëllimin që Ligji i Arsimit të Lartë i atribuon programeve bachelor. Struktura dhe përmbajtja e programit, përmbajtja e silabuseve, raporti teori-praktikë synon të garantojë formimin të mirë të studentëve nga pikëpamja njohurive dhe aftësimit praktik, për t'ju përgjigjur dinamikave të tregut lokal dhe global.<br><br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Element i rëndësishëm është fokusimi i studentëve në raporte ndërveprimi me tregun e punës përmes orëve të hapura, Panairit të Punës, vizitave në biznese dhe konkurseve të mbështetura nga biznesi. Mënyra si konceptohet dhe zhvillohet praktika mësimore, krijon hapësira për aftësimin, por dhe oportunitet për t'u punësuar. FEUT dhe departamentet përgjegjëse për programin e studimit BA në AB mund të krijojnë oportunitete të shumta në raportet me bizneset, në projektet e përbashkta, ndërkombëtare dhe në përfshirjen e studentëve. Studimi i gjurmimit të të diplomuarve nga programi BA në AB tregon praninë dominuese të sektorit privat, por një pjese e konsiderueshme e të diplomuarve orientohet edhe drejt sektorit publik.<br><br>*Dokumenti*: 017: Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve 2025;<br>*Dokumenti 017.1 Studim per tregun e punes pas daljes se studenteve Departamenti i Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 017.2: Studime të Tregut te Punes Departamenti Marketing -Turizem 2020-2022* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson që struktura dhe organizimi është në përputhje me objektivat, përmbajtja është në një proces përmirësim dhe* |

| | |
|---|---|
| | *përditësimi në përputhje me zhvillimet në tregun e punës dhe qasjet e reja të shoqërisë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Tregu i punës është në disa dinamika lokale dhe globale, të cilat kanë kapërcyer të gjitha projeksionet e ekpertëve të hartimit të programeve. Ekzistojnë praktika të mira të bashkëpunimit FEUT- industri, por ato kanë nevojë të bëhen më të qëndrueshme, në nivel departamenti.<br>Programi BA në AB që po akreditohet karakterizohet nga një numër i madh studentësh, avantazh ky që do të duhet të vlerësohet dhe të shoqërohet me shumë dinamikë<br>Pozitive janë raportet e universitetit/departamentit/pedagogëve me organizatat/bizneset, por dhe shumë bashkëpunime të tjera ndërkombëtare – që përbëjnë dhe qasjen e departamenteve përgjegjëse për programin e studimit. Panairi i Punës, Konferencat dhe disa konkurse studentore, vizitat në biznes, praktikat mësimore, leksionet me të ftuar nga biznesi/institucionet përbëjnë një mundësi për ndërveprim, feedback dhe propozime konkrete. Pozitiv është fakti që një pjesë e pedagogëve të jashtëm vijnë nga eksperienca biznesi, drejtimi institucionesh dhe organizatash me peshë, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ndërveprimin universitet – biznes ose më mirë departamente- biznes.<br>Panairi i karrierës sugjerohet të ruajë periodicitetin vjetor.<br><br>*Dokumenti 012: Udhezim mbi funksionimin e zyres se karrieres FEUT2025;*<br>*Dokumenti 012.1: Informacion mbi Qendren e Karrieres;*<br>*Dokumenti 012.6: Raport panairi punes 2022;*<br>*Dokumenti 012.7: Raport panairi ipunes 2023;*<br>*Dokumenti 012.2: Aktivitet-Njoftimet -Zyra e Karrierës 2021-2025;*<br>*Dokumenti 012.3: Raport Dita e Karrieres 2025;*<br>*Dokumenti 061: Alumni_FE 2025* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime | Përfshirja e studentëve në diskutimet e përmirësimit të programit bëhet përmes rrugëve formale dhe joformale. |

| | |
|---|---|
| studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Drejtuesit e departamenteve, pedagogët u shprehën gjatë takimeve në institucion që në mënyrë periodike takohen dhe diskutojnë me studentët për procesin mësimor, problematikat e ndeshura, përmbajtjen e lëndëve etj. Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, studentët janë pjesë e Senatit, NJSBC dhe GVB. Gjithashtu, në nivel institucioni, bëhen pyetësorë për vlerësimin e programit dhe të mësimdhënies, rezultatet e të cilave shërbejnë për të diskutuar e marrë vendime të mëtejshme, mbledhjet periodike të departamentit me studentët, të cilat mund të planifikohen me tematikat dhe grupet e nivele të ndryshme.<br><br>*Dokumenti: RVB*<br>*Dokumenti 002. Statuti i UT*<br>*Dokumenti 005.1.1: Rregullore e UT 2022* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | FEUT dhe departamentet përgjegjëse për programin e studimit, bashkëveprojnë në mënyrë formale dhe joformale me një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh – alumni përfshirë, institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat i japin mundësinë të përditësohen me nevojat e tregut, sfidat dhe inovacionet.<br><br>*Dokumenti: RVB*<br>*Dokumenti 034: Marreveshjet Erasmus + UT dhe me IAL të tjera;*<br>*Dokumenti:034.1: Projektet e FE 2024 Kombetare;*<br>*Dokumenti: 034.1.2_Listë Aplikim Projekte Brenda vendit 2024-2025:*<br>*Dokumenti:034.2: Projekte në Implementim nderkombetare ongoing 2024-2025;*<br>*Dokumenti:034.2.2: Listë Aplikim Projekte Nderkombetare 2024-2025;*<br>*Dokumenti:035: Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion te realizimit të programit të studimeve;* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se në mënyrë formale dhe joformale, studentët bëhen pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm. Gjithashtu, vlen të theksohet dhe mënyra se si bashkëpunojnë më institucione, biznese dhe organizata të tjera dhe si ndikonin veprimtaritë e tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

Adresa: Blloku Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al E-mail: info@ascal.al

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Mësimdhënia në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Marketigut e Turizmit në FEUT bazohet në kuadrin rregullator në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë në funksion të këtij procesi janë përkatësisht rregullorja e studimeve në UT; rregullorja e FE, dhe rregulloret e dy departamenteve që administrojnë programin, gjithashtu dhe vetë rregullorja e programit të studimit BA në AB në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, praktika profesionale etj. Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Gjithashtu mënyra e vlerësimit të studentëve është prezantuar në syllabusin e çdo lënde.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti;014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti:076.1: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti:076.1: Plani mesimor 2022-2023 Shqip;*<br>*Dokumenti:019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:042: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit;*<br>*Dokumenti:120: Qendra Inovacionit Marketing Turizëm;* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, | Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Pozitive është fakti që PAE i dy departamenteve që |

| | |
|---|---|
| duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | administrojnë programin e studimit ka qenë i qëndrueshëm në vitet e fundit (30 dhe 18 PAE respektivisht Departamenti i Menaxhimit si edhe ai i Marketingut dhe Turizmit).<br><br>Gjithashtu GVJ nga vizita në institucion në takimin me studentët konstatoj jo vetëm entuziazëm por edhe vlerësim për ofrimin në gjuhën angleze të këtij programi.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion, takimi me studentët;*<br>*Dokumenti: 006: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Manaxhimit;*<br>*Dokumenti:014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti:019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:042: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit;*<br>*Dokumenti:120: Qendra Inovacionit Marketing Turizëm;*<br>*Dokumenti:047: Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB;*<br>*Dokumenti:076.1: Plani mesimor 2024-2025;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Bazuar në takimin me stafin e Departamentit të Menaxhimit dhe Departamentin e Marketigut të Turizmit në FEUT rezulton se UT mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projekteve ERASMUS+. Bazuar në faktin se UT ka qenë mjaft aktiv si pjesëmarrës në disa projekte të ERASMUS + është arritur të realizohet një numër i kënaqshëm mobilitetit të stafit akademik.<br><br>*Dokumenti: RVB*<br>*Vizita në institucion, takimi me stafin akademik;*<br>*Dokumenti 109: Trajnimi i stafit të ri akademik për metodologjitë e mësimdhënies;*<br>*Dokumenti 039: Udhëzues FEUT për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative;*<br>*Dokumenti 032.1: Të dhëna pë bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare të Fakultetit;*<br>*Dokumenti 034: Marrëveshjet Erasmus +UT dhe IAL të tjera;* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive | Personeli akademik që mbulon këtë program ka eksperiencën dhe kualifikimin e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e menaxhimit dhe administrimit në përputhje me |

| | |
|---|---|
| dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | lëndët që karakterizojnë drejtimet përkatëse. Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik.<br><br>*Dokumenti:024: Të dhëna Tabelare për personelin akademik, në të gjitha programet e studimit;*<br>*Dokumenti:020: CV e stafi akademik të programit të studimit të Departamentit të Menaxhimit;*<br>*Dokumenti:020.1: CV e stafi akademik të programit të studimit të Departamentit të Marketing-Turizmit;*<br>*Dokumenti:092: Stafi i Departamentit të Menaxhimit;*<br>*Dokumenti:092.1: Stafi i Departamentit të Marketing-Turizmit;*<br>*Dokumenti:014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;*<br>*Dokumenti:043: Puna kërkimore shkencore;*<br>*Dokumenti; 043.1: Kërkimi Shkencor FEUT;* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | UT krahas akteve rregullatore në funksion të procesit mësimor shkencor. Me vendim të Senatit të UT ka miratuar manualin e cilësisë në të cilin dikton ngritja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Anëtarë të NJSBC janë përfaqësues nga çdo departament.<br><br>NJSBC funksionon në baze të rregullores përkatëse të saj. Në këtë rregullore sanksionohen funksionet dhe mënyra e operimit të kësaj njësie. Gjithashtu në nivel institucional funksionon edhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Standardeve që në bashkëpunim me NJSBC koordinon punën lidhur me funksionin e kësaj njësisë. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur pranë ASCAL-it në evidentuam aktivitetet e NJSBC_së ku realizohen edhe analizat e vlerësimit të studenteve për procesin mësimor.<br><br>*Dokumenti:040.8: Plani i Veprimtarisë NJSBC 2024-2025;*<br>*Dokumenti:040.5: Plani i Veprimtarisë NJSBC 2021-2022;*<br>*Dokumenti:040.6: Plani i Veprimtarisë NJSBC 2022-2023;*<br>*Dokumenti:040.3: Aktiviteti i NJSBC FEUT Materiale Përmbledhëse 2022-2025;*<br>*Dokumenti:002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti:005_Rregullore e UT 2010 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti:005.1: Rregullore_UT 2022;*<br>*Dokumenti:007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti:014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij;* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | GVJ konstaton se FEUT krahas akteve rregullatore në funksion të procesit mësimor shkencor, në kuadër të DM dhe DMT, koordinatorët akadmikë kanë përgjegjësinë të raportojnë për çdo çështje apo ankesë që mund të paraqitet nga studentët sipas rastit. Me vendim të Senatit të UT_së është miratuar edhe manuali i cilësisë me të cilin është ngritur dhe funksioonon edhe Njësisa se Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Anëtarë të NJSBC janë përfaqësues nga çdo departament.<br><br>NJSBC funksionon në baze të rregullores përkatëse të saj. Në këtë rregullore sanksionohen funksionet dhe mënyra e operimit të kësaj njësie. Gjithashtu në nivel institucional funksionon edhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Standardeve që në bashkëpunim me NJSBC koordinon punën lidhur me funksionin e kësaj njësisë. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur pran ASCAL-it ne evidentuam një relacion në formë raporti mbi analizën e pyetësorëve me studentet e programit Bachelor në AB. Në të bëhet analiza e vlerësimit të studenteve për procesin mësimor. Strukturat/ njësitë e ngritura në nivel institucional kanë një historik relativisht të shkurtër dhe si rrjedhoje kanë realizuar vetëm vlerësimin me anën e anketimeve të studenteve.<br><br>*Dokumenti 040.10: Raport mbi aplikimin e instrumentave të cilësisë NJSBC;*<br>*Dokumenti:002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti:040.8: Plani i Veprimtarisë NJSBC 2024-2025;*<br>*Dokumenti:040.5: Plani i Veprimtarisë NJSBC 2021-2022;*<br>*Dokumenti:040.6: Plani i Veprimtarisë NJSBC 2022-2023;*<br>*Dokumenti:040.3: Aktiviteti i NJSBC FEUT Materiale Përmbledhëse 2022-2025;*<br>*Dokumenti:002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti:005_Rregullore e UT 2010 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti:005.1: Rregullore_UT 2022;*<br>*Dokumenti:007: Rregullore e programeve bachelor 2025;* |
| **Konkluzione** | *GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se UT realizon në procesin mësimor gjithë elementët e duhur të ndara në leksione ,seminare , projekte e detyra kursi, praktike profesionale etj.*<br><br>*Institucioni në përmbushje të akteve ligjore dhe nënligjore ka ngritur strukturat përkatëse që promovojnë vlerësojnë dhe mbikëqyrin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.2<br>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional njësie kryesore, baze ashtu edhe për programin e studimit BA në AB. Në rregulloren e studimeve të BA në AB janë të përcaktuara parimet dhe kriteret kryesore të vlerësimit të dije.<br>Më të detajuara kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive përcaktohen në rregulloren e këtij programi studimi si dhe në programin e çdo lënde (syllabusin) në pjesën e vlerësimit. Këto dokument janë të aksesuseshme si nga stafi akademik edhe nga studentt.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti:007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti:009: Rregullore e Sekretarisë Mësimore FEUT 2025;*<br>*Dokumenti:123: Struktura e Vitit Akadmeik Bachelor në Administrim Biznesi;*<br>*Dokumenti:019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:128: Skema e Vlerësimit Bachelor Administrim Biznesi;* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet:<br>• Informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në te;<br>• Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre;<br><br>Pedagogu i lëndës në fillim të zhvillimit semestrit sqaron dhe informon studentet për kohën dhe elementet e vlerësimit të vazhduar dhe atë përfundimtar.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti:007: Rregullore e programeve bachelor 2025;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti:009: Rregullore e Sekretarisë Mësimore FEUT 2025;*<br>*Dokumenti:123: Struktura e Vitit Akadmeik Bachelor në Administrim Biznesi;*<br>*Dokumenti:019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:128: Skema e Vlerësimit Bachelor Administrim Biznesi;*<br>*Dokumenti:076.1: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti:006.1: Rregullore Njësia Bazë DMT;*<br>*Dokumenti:006: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Manaxhimit;* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan gjatë shqyrtimit të programeve të lëndëve si dhe takimit me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit.<br><br>*Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.*<br>*Dokumenti: RVB*<br>*Dokumenti:007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti:009: Rregullore e Sekretarisë Mësimore FEUT 2025;*<br>*Dokumenti:123: Struktura e Vitit Akadmeik Bachelor në Administrim Biznesi;*<br>*Dokumenti 128: Skema e Vlerësimit Bachelor Administrim Biznesi;*<br>*Dokumenti 076.1: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti 006.1: Rregullore Njësia Bazë DMT;*<br>*Dokumenti 006: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Manaxhimit;* |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | GVJ konstaton se mendimi i studenteve në FEUT për cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësimi i tyre për performancën e pedagogut realizohet nga NJSBC nëpërmjet anketimit. Ky anketim realizohet në fund të çdo semestri. Raporti i rezultateve të dala hartohet nga kjo njësi dhe analizohet në DM dhe DMT. Si njësitë bazë të këtij program studimi. Në vijimësi, realizohen diskutime në nivel departamenti, për të identifikuar pikat e forta dhe fushat që kërkojnë ndërhyrje apo ndryshim në mënyrën e mësimdhënies.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion, takimi me studentët;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti:002: Statuti i Universitetit të Tiranës 2018;*<br>*Dokumenti: 003: Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028;*<br>*Dokumenti:040.3: Aktiviteti i NJSBC FEUT Materiale Përmbledhëse 2022-2025;*<br>*Dokumenti:040.8: Plani i Veprimtarisë NJSBC 2024-2025;*<br>*Dokumenti:040.5: Plani i Veprimtarisë NJSBC 2021-2022;*<br>*Dokumenti:040.6: Plani i Veprimtarisë NJSBC 2022-2023;*<br>*Dokumenti:041: Vlerësimi i pedagogut;*<br>*Dokumenti:04101: Pyetësori i Personelit Akademik i Universitetit të Tiranës;* |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit u evidentua që realizimi i procesit mësimor nëpërmjet metodave të mirënjohura kombinohet me një qasje interaktive mes tyre duke nxitur diskutimet në grupin e tyre. Kjo realizohet edhe gjatë prezantimit të detyrave të kursit duke krijuar një ambient bashkëpunues. Grupi i studentëve në takim vlerësonte maksimalisht formën e diskutimit me grupin e tyre gjate zhvillimit të mësimit. Numri i vogël i studenteve në kurs është edhe një faktor që ka nxitur këtë marrëdhënie interaktive mes pedagogut dhe studentit.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti:076.1: Plani mesimor 2024-2025;*<br>*Dokumenti:019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:109: Trajnimi i stafit të ri akademik për metodologjitë e mësimdhënies;*<br>*Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.* |
| **Konkluzione** | *GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plote kuadrin rregullator ,mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dije të studentëve gjatë procesit mësimor.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, | Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat tashme të njohura të përdorura në IAL në Shqipëri. GVJ, gjatë vizitës |

| | |
|---|---|
| dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë procesit të zhvillimit të këtyre lëndëve vlerësohen me nga 20% deri në 30 % (angazhim në seminar, provimi i ndërmjetëm dhe detyra e kursit), një nivel ky relativisht i ulët për një vlerësim të vazhduar të studentit, ndërsa provimi përfundimtar zë deri 70% të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit për të cilët GVJ ka dhënë sugjerimet për përmirësim. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion,*<br>*Dokumenti:007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti:009: Rregullore e Sekretarisë Mësimore FEUT 2025;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim. GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekreti dhe konfidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Programi BA në AB ka implementuar përdorimin e Microsoft Teams për zhvillimin e provimeve online, me mbikqyrjen e drejtëpërdrejtë përmes video-konferencës. Mendojmë që në kuadrin rregullator të institucionit dhe rregulloren e programit të evidentohet edhe ky lloj vlerësimi dijesh.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti:007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti:009: Rregullore e Sekretarisë Mësimore FEUT 2025;*<br>*Dokumenti:019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:105: Manual përdorimi Microsoft Teams;* |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës | Bazuar në rregulloret e UT, dhe në rregulloren e këtij programi dhe programet e lëndëve, GVJ evidentoj praktika vlerësimi të |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi se pedagogët e lëndëve paraqesin çdo fillim semestri te studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundësohet nga vetë ato dhe biblioteka. Gjithashtu FEUT vë në dispozicion të studentëve informacione on-line nga burime të ndryshme elektronike.<br><br>Literatura bazë dhe ndihmëse e programit u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:045.12: Marrveshja për bibliotekat online;*<br>*Dokumenti:045.3: Biblioteka në UT dhe sistemin e Informacionit;*<br>*Dokumenti:045.11: Foto të bibliotekës;*<br>*Dokumenti:045.13: Manual J-store;*<br>*Dokumenti:045.7: JSTORE Agreement UT 2020;* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi se në bibliotekë raportohet përditësim i literaturës me botime të viteve të fundit për të informuar stafin akademik, ndihmës-akademik dhe studentët, mbi botimet e fundit.<br><br>Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj të cilat shpërndahen si materiale shtesë me iniciativë të pedagogëve. GVJ konstatoi gjithashtu nga dokumentacioni në dispozicion se UT ka ndërmarrë masa për shtimin e fondit të bibliotekës në përgjigje të kërkesave të pedagogëve si edhe nevojave të njësive bazë.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 045.10: Rregullore e Bibliotekës;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:045.3: Biblioteka në UT dhe sistemin e Informacionit;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se FEUT nëpërmjet Bibliotekës :"Joseph Limprecht" vë në dispozicion të studentëve dhe stafit një fond të përgjithshëm i cili arrin 5703 libra dhe 282 tituj revistash. Biblioteka ofron një hapësirë studimi prej 11 kompjuterash dhe 200 vende studimi. Ndërsa DM dhe DMT per tre vitet e fundit akademike ofron në dispozicion të studentëve 148 Tituj dhe 491 copë libra.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:045.12: Marrveshja për bibliotekat online;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti:045.3: Biblioteka në UT dhe sistemin e Informacionit;*<br>*Dokumenti:045.11: Foto të bibliotekës;*<br>*Dokumenti:045.13: Manual J-store;*<br>*Dokumenti:045.7: JSTORE Agreement UT 2020;* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | GVJ konstatoi nga dokumentacioni por edhe vizita në institucion sikurse e theksoj edhe ne kriterin 3, se biblioteka disponon një fond të përgjithshëm të pasur me tituj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. Biblioteka ofron një hapësirë studimi prej 11 kompjuterash dhe 200 vende studimi.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:045.12: Marrveshja për bibliotekat online;*<br>*Dokumenti:045.3: Biblioteka në UT dhe sistemin e Informacionit;*<br>*Dokumenti:045.11: Foto të bibliotekës;*<br>*Dokumenti:045.13: Manual J-store;*<br>*Dokumenti:045.7: JSTORE Agreement UT 2020;* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programin BAAB, që FEUT ofron për të gjithë dhe pa pagesë biblotekën online. Biblioteka ofron informacione online nga burime të ndryshme elektronike. Biblioteka Shkencore e FEUT, në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim AADF ka finalizuar marrveshjen për abonim në bibliotekën digjitale JSTORe cila ofron 12 milion artikuj shkencor, si edhe 85.000 libra dhe 2 milion dokumenta në 75 disiplina.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:045.12: Marrveshja për bibliotekat online;*<br>*Dokumenti:045.3: Biblioteka në UT dhe sistemin e Informacionit;*<br>*Dokumenti:045.11: Foto të bibliotekës;*<br>*Dokumenti:045.13: Manual J-store;*<br>*Dokumenti:045.7: JSTORE Agreement UT 2020;* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, | GVJ konstatoi nga dokumentacioni por edhe vizita në institucion sikurse e theksoj edhe ne kriterin 3 dhe 4, se biblioteka disponon një fond të përgjithshëm të pasur me tituj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. Biblioteka ofron një |

| | |
|---|---|
| që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | hapësirë studimi prej 11 kompjuterash dhe 200 vende studimi me 70 tavolina komplekse.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:045.12: Marrveshja për bibliotekat online;*<br>*Dokumenti:045.3: Biblioteka në UT dhe sistemin e Informacionit;*<br>*Dokumenti:045.11: Foto të bibliotekës;*<br>*Dokumenti:045.13: Manual J-store;*<br>*Dokumenti:045.7: JSTORE Agreement UT 2020;* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | GVJ konstatoi se Biblioteka e Fakultetit operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve në orarin e vënë në dispozicion.<br>Orari i shërbimit të bibliotekave, i shpallur gjatë ditëve të javës është: 8:30- 19:30. Biblioteka disponon një fond të përgjithshëm të pasur me tituj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. Biblioteka ofron një hapësirë studimi prej 11 kompjuterash dhe 200 vende studimi me 70 tavolina komplekse.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:045.12: Marrveshja për bibliotekat online;*<br>*Dokumenti:045.3: Biblioteka në UT dhe sistemin e Informacionit;*<br>*Dokumenti:045.11: Foto të bibliotekës;*<br>*Dokumenti:045.13: Manual J-store;*<br>*Dokumenti:045.7: JSTORE Agreement UT 2020;* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe | Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se stafi i punonjësve të bibliotekës është përgjegjës për raportimin e informacionit që ka të bëjë me përditësimin e fondit fizik dhe fondit on-line të bibliotekës përkatëse.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti:045.12: Marrveshja për bibliotekat online;* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | *Dokumenti:045.3: Biblioteka në UT dhe sistemin e Informacionit;*<br>*Dokumenti:045.11: Foto të bibliotekës;*<br>*Dokumenti:045.13: Manual J-store;*<br>*Dokumenti:045.7: JSTORE Agreement UT 2020;* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur plotësisht, kjo e konstatuar nga dokumentacioni në dispozicion, vizita me stafin dhe studentët e programit BAAB. Literatura bazë dhe ndihmëse e programit u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion se sekretaria e FEUT_së është përgjegjëse si edhe realizon sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomim.<br>Gjatë takimit në sekretarinë e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve të programit BAAB, të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi informatik që përdoret nga FEUT, është një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre. Sistemi mundëson efikasitet në administrimin e bazës së të dhënave nga ana e stafit akademik, marrje e informacionit në kohë reale nga ana e studentit, shërbime më të mira sekretarie që lehtëson proceset e hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave. Gjithashtu stafi akademik përdor edhe platformën Microsoft Teams 365 për komunikimin dinamik me studentët.<br><br>*Dokumenti: RVB;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 009: Rregullore e Sekretarisë mësimore FEUT 2025;*<br>*Dokumenti:077: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT;*<br>*Dokumenti:046.3: Upgrade I aplikimit software e-Student-UT;*<br>*Dokumenti:046.1: Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit Student;*<br>*Dokumenti:046.2: Përdorues të SIM-print screen;*<br>*Dokumenti:105: Manual përdorimi Microsoft Teams;*<br>*Dokumenti:104: Rregullore e posaçme e për proçedurën e zhvillimit të provimit online;* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik i angazhuar në programin BAAB menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore. Ndërsa, Drejtoria e Financës posedon dhe përditëson informacionin në lidhje me stafin akademik dhe administrativ, në funksion të përcaktimit të kategorisë së punonjësve, raportit për ngarkesën mësimore dhe gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me pagat.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti: 117: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Rektoratit;*<br>*Dokumenti:044.01: Skeda e Dosjes personale e stafit;*<br>*Dokumenti:011.4: Model kontrate personale akademik me kohë të pjesshme;*<br>*Dokumenti:011.3: Model kontrate personale akademik me kohë të plotë;* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se Sistemi Informatik i UT_së mundëson efikasitet në administrimin e të dhënave nga ana e stafit akademik, marrje të informacionit në kohë reale nga ana e studentëve, shërbime më të mira sekretarie që lehtësoi proçeset e hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave, paraqitjen në rrjet të grafikut të provimeve, të rezultateve, krediteve, kurrikulës dhe programet lëndore. Rregullorja e këtij programi përcaktoi funksionet e sistemit, si dhe detyrat e përgjegjësitë e personave të përfshirë. Ndërsa hyrja në sistem u mundësua edhe nëpërmjet faqes zyrtare të internetit.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti: 046.3: Ugrade i aplikimit software e-Student;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti: 046.2: Përdorues të SIM-print screen;* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion se, Sistemi Informatik i UT_së është sistemi që mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për stafin dhe studentët e UT_së, por GVJ konstatori si nga RVB dhe nga vizita në institucion ky sistem elektronik konsiderohet si metodë interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët së bashku me platformën Microsoft Teams. FEUT gjithashtu publikon informacione në faqen e vet zyrtare, https://feut.edu.al/, e cila përditësohet vazhdimisht. GVJ konstatoi gjithashtu se plani strategjik i zhvillimit të IAL_së parashikon që sistemi interaktiv i komunikimit të integrojë mësimin elektronik dhe të nxënit nëpërmjet TIK-ut në funksion të përmirësimit të aftësive pedagogjike të stafit akademik dhe cilësisë së mësimdhënies.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti: 088: Manual sistemi e-Studentet;*<br>*Dokumenti:077: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT;*<br>*Dokumenti:078: Komunikim me MS Teams ndërmjet studentit dhe pedagogut;*<br>*Dokumenti:55: Komunikimi me student me Teams për mbikqyrje diplome;* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të IAL_së garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti: 088: Manual sistemi e-Studentet;*<br>*Dokumenti:077: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT;*<br>*Dokumenti:046.3: Upgrade I aplikimit software e-Student-UT;*<br>*Dokumenti 009: Rregullore e Sekretarisë mësimore FEUT 2025;* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të | GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të IAL_së publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu në rrjetet sociale çdo |

| | |
|---|---|
| paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | fakultet dhe departament pasqyron informacion të vazhdueshëm për të interesuarit.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti: 099: Politikat e privatësisë FEUT;*<br>*Dokumenti:051: Politikat e marketingut të programit të studimit;*<br>*Dokumenti:069: Mobilitete Outgoing Student FEUT;*<br>*Dokumenti:032: Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale Mars 2025;* |
| **Konkluzione** | *GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht, UT përdor Sistemi Informatik të brendshëm të UT_së gjithashtu edhe platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë Universitetit.*<br>*Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të IAL_së. Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet, UT publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet në gjuhën shqipe.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ duke u bazuar në informacionin e dhënë në DVV dhe RVB, gjithashtu në vizitën pranë institucionit GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Marketing Turizmit funksionojnë në përbërje të njësisë kryesore (Fakultetit të Ekonomisë), dhe padyshim janë pjesë e njësisë së vetme shpenzuese të UT_së, i cili ndërton buxhetin në nivel fakulteti në bazë të kërkesave dhe planit për mbështetje financiare të nevojshme për mbarvajtjen e programeve të studimit që janë pjesë e këtij fakulteti. Buxhetimi finaciar hartohet çdo vit nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës në drejtimin e administratorit të UTsë. Buxheti ndahet sipas përcaktimeve të rregullores financiare, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Gjithashtu hartimi i buxhetit të UT_së fillon nga njësia bazë, pra që nga |

| | |
|---|---|
| | departamenti, duke marrë parasysh nevojat e secilit prej tyre duke, u varur edhe nga niveli i të ardhurave që pritet të realizojë çdo department. Ndërsa plani i financimit miratohet në nivel institucional nga Bordi i Administrimit ku përfshihen të gjitha kostot dhe të ardhurat e parashikuara.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti:072.4: Projekt Buxheti 2025 FEUT;*<br>*Dokumenti:073.4: Buxheti i miratuar 2025 FEUT;*<br>*Dokumenti:73.5: Buxheti FEUT për studentë dhe veprimtari shkencore 2022-2024;*<br>*Dokumenti:081.1:Parashikimi i buxhetit për vitin 2025 Dep. Menaxhim;* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV se hartimi i planit të financimit të njësive bazë, përgjegjëse për programin e studimit BAAB, bazohet në strukturën buxhetore që përdoret për hartimin e buxhetin e shtetit, sipas zërave kryesorë buxhetorë: Shpenzime nga grandi buxhetor, si dhe Shpenzimet nga të ardhurat e veta. Në vijim plani i financimit të DM dhe DMT detajohet në mënyrë më analitike me gjithë elementët e shpenzimeve që parashikon për mbulimin e shpenzimeve operative, burimeve njerëzore, investimet për logjistikën dhe pajisjet.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti:072.4: Projekt Buxheti 2025 FEUT;*<br>*Dokumenti:073.4: Buxheti i miratuar 2025 FEUT;*<br>*Dokumenti:73.5: Buxheti FEUT për studentë dhe veprimtari shkencore 2022-2024;*<br>*Dokumenti:081.1: Parashikimi i buxhetit për vitin 2025 Dep. Menaxhim;*<br>*Dokumenti:081: Realizimi i buxhetit për vitin 2024 dhe detajimi i kuotave per buxhetin 2025;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | AL_ja auditohet në mënyrë periodike nga katër hallka kryesore. Auditimi i brendshëm financiar nga strukturat e kontrollit të brendshëm të institucionit si Sektori i Auditimit të Brendshëm si dhe Sektori i Auditimit të Performancës me nga 3 punonjës sejcili. Auditimi i jashtëm (i kryer në çdo dy vjet) nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si edhe nga auditimi i jashtëm, i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. |

| | |
|---|---|
| | Universiteti bën të njohur pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera për të pasur transparencë ndaj publikut.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti:072.4: Projekt Buxheti 2025 FEUT;*<br>*Dokumenti:153.01: MIratimi i Planit Strategjik të Auditimit, 2021-2023;*<br>*Dokumenti:152.02: Programi i auditit të brendshëm;*<br>*Dokumenti:152.03: Programi vjetor i auditimit viti 2021;* |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Bazuar në informacionin e DVV në fund të çdo viti UT, rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti:072.4: Projekt Buxheti 2025 FEUT;*<br>*Dokumenti:073.4: Buxheti i miratuar 2025 FEUT;*<br>*Dokumenti:73.5: Buxheti FEUT për studentë dhe veprimtari shkencore 2022-2024;*<br>*Dokumenti:081.1: Parashikimi i buxhetit për vitin 2025 Dep. Menaxhim;*<br>*Dokumenti:081: Realizimi i buxhetit për vitin 2024 dhe detajimi i kuotave per buxhetin 2025;* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | UT është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UT_së janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Në rastet kur ka kërkesë të njësisë bazë dhe me miratim të organeve drejtuese të UT_së, në rastet kur nevojitet financim shtesë, apo përmirësim i situatës financiare, ri-planifikohen ndërhyrje të posaçme në zërat e shpenzimeve (apo në regjistrin e prokurimeve) për nevoja të ndryshimeve eventuale të financimit të programeve të studimeve, duke garantuar mbarëvajtje të veprimtarisë akademike dhe kërkimit shkencor apo të programeve të studimit.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Dokumenti:072.4: Projekt Buxheti 2025 FEUT;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti:073.4: Buxheti i miratuar 2025 FEUT;*<br>*Dokumenti:73.5: Buxheti FEUT për studentë dhe veprimtari shkencore 2022-2024;*<br>*Dokumenti:081.1: Parashikimi i buxhetit për vitin 2025 Dep. Menaxhim;*<br>*Dokumenti:081: Realizimi i buxhetit për vitin 2024 dhe detajimi i kuotave per buxhetin 2025;*<br>*Dokumenti 004: Plani Strategjik i Programit*<br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit të Tiranës 2018;* |
| **Konkluzione** | *GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht, pasi u konstatua se UT harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti dhe njësie bazë dhe bën analiza financiare në nivel njësie bazë. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe raportet përcillen deri në njësinë bazë. UT si institucion buxhetor, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Programi i studimit bachelor në Administrim-Biznes me 180 ECTS është konceptuar dhe zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimt të Lartë Nr 80/2015 dhe VKM Nr 41 dt 24.01.2018, për Elementët e Programit të Studimit të Ofruar nga IAL-të, si dhe një sërë dokumentash ligjorë dhe rregullatorë si:<br>-Statuti UT;<br>-Rregullorja e UT;<br>-Rregullorja e Departamenteve të Menaxhimit dhe Marketingut e Turizmit |

| | |
|---|---|
| | -Rregullorja e Programit të Studimit<br>Të gjitha këto akte mbulojnë të gjithë veprimtarinë e punës së njësisë kryesore dhe bazë nga hyrja e studentëve në programin master, deri në diplomimin e tyre. Departamenti si rregull propozon tek Dekani kriteret e pranimit të studentëve në BA në AB, nisur nga kriteret ligjore.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 06: Rregullore per organizimin dhe funksionimin e Departamentit te Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 006.1 Rregullore Njësia Bazë DMT 2022;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 071: Kriteret e propozuara te dhy viteve të fundit 2024-2025;*<br>*Dokumenti 047.3: Vendim i Dekanit mbi Kriteret e pranimit 2024-2025;*<br>*Dokumenti 047.4: Propozim kuotash_2024-2025;*<br>*Dokumenti 047.6: Vendim Dekanati Kuotat e Pranimit 2024-2025.* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Studentët që nga momenti i hyrjes deri në dalje nga studimet gëzojnë të drejtën të trajtohen në mënyrë të njëjtë në të gjithë elementët dhe strukturat përgjegjëse të njësisë kryesore dhe bazë të programit BA në AB, të marrin pjesë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret në një sërë organesh kolegjiale nga Senati, në proceset e akreditimit përmes pjesëmarrjes në grupet e Vlerësimit të Brendshëm, në Këshillin e Etikës, etj. Studentët gëzojnë të drejtën e votës në zgjedhjet për Këshillin Studentor. Studentët gëzojnë gjithashtu të drejtën të përfitojnë bursa studimi, bursa Erasmus, të përfshihen në projekte, të marrin pjesë në aktivitete e seminare extracurriculare, etj. Një dokument tjetër i rëndësishëm për orientimin e kandidatëve që duan të studjojnë në FEUT është Guida e Studentit<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 006: Rregullore per organizimin dhe funksionimin e Departamentit te Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 006.1 Rregullore Njësia Bazë DMT 2022;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti: RVB BA administrim biznes*<br>*Dokumenti 115: Guida e Fakultetit të Ekonomise* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti Ekonomisë bëjnë të aksesueshme në faqet e tyre zyrtare në internet të gjithë informacionin që ndihmon të gjithë të interesuarit (aplikantët për studime dhe studentët aktuale) për të marrë vendime dhe kuptuar proceset.<br>Krahas informacioneve që kanë të bëjnë me aspektet rregullatore të universitetit dhe fakultetit, që ndihmojnë studentët për të kuptuar gjithë procesin nga aplikimi, përzgjedhja, rregjistrimi, transferimi dhe njohja e krediteve, diplomimi, në WEB gjenden programet e studimit, departamentet, stafi akademik dhe shumë informacione të tjera përshirë dhe email e kontaktit të pedagogëve.<br>Në këtë link të WEB https://feut.edu.al/studentet, studentët gjejnë të gjitha informacionet e nevojshme për jetën e tyre studentore, si dhe shumë nga procedurat, formularët për praktikën dhe diplomën.<br>Ndërsa në këtë link https://feut.edu.al/lajmerime/1950-mbi-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-ne- ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-fakultetin-e-ekonomise-ut-per-vitinakademik-2024-2025gjejnë kushtet e pranimit në BA në AB, programin, vlerësimin dhe disa elementë të tjerë të rregullores së programit të studimit. Në lidhje me stafin e departamenteve e departamenteve përgjegjës për programin e studimit i gjithë informacioni gjendet në linqet:<br>-https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet/departamenti-i-manaxhimit/stafi-i-departamentit-manaxhim<br>-https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet/departamenti-i-marketingut<br>Në faqen zyrtare, Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti I Marketingut dhe Turizmit, përgjegjës për programin BA në AB publikon të gjitha thirrjet në interes dhe për studentët.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 006: Rregullore per organizimin dhe funksionimin e Departamentit te Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 006.1 Rregullore Njësia Bazë DMT 2022;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti: RVB BA administrim biznes* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit | Kriteret e pranimit të studentëve në BA në AB bazohen plotësisht më Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në Statutin e UT. Departamentet përgjegjëse për programin e studimit kanë të drejtë të formulojnë kriteret shtesë dhe kuotat e pranimit, të |

| | |
|---|---|
| përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | cilat fillimisht miratohen në Fakultet dhe më pas në Senatin e UT, ky i fundit bën propozimin e tij për MAS.<br>Studentët kanë akses të plotë në të gjithë dokumentacionin statutor, rregullator dhe informative mbi programin, kriteret, stafin akademik, planin mësimor, rregulloren e programit të studimit, sylabuset e lendeve, kontaktet e pedagogëve etj.<br>Natyrisht, faqet e mediave sociale, Guida e Studentit, kontribuojnë në dhënien e informacionit të duhur për studentët. Kontaktet fizike në FEUT, Qendrën e Karrierës, Sekretarinë e FE, dhe një sërë zyrash të tjera mundësojnë kalimin e të gjithë informacionit dhe suportit ndaj studentëve aktuale dhe studentëve të pritshëm.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 006: Rregullore per organizimin dhe funksionimin e Departamentit te Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 006.1 Rregullore Njësia Bazë DMT 2022;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti: RVB BA administrim biznes*<br>*Dokumenti 115: Guida e Fakultetit të Ekonomise*;<br>*Dokumenti 115.1: Guida studentore DMT;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);*<br>*Dokumenti 076: Plani mesimor 2024-2025.* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Faqja e internetit të FEUT ka të gjithë informacionin e duhur për procesin e rekrutimit të studentëve në BA në AB. Gjithashtu, Fakulteti Ekonomisë prodhon dhe vë në dispozicion të publikut dhe material të tjera të cilat japin informacion mbi programet, procedurat, aplikimin, rregulloren e programit etj.<br>Një dokument tjetër i rëndësishëm për orientimin e kandidatëve që duan të studjojnë në FEUT është Guida e Fakultetit dhe Guida e Studentit. Gjithashtu, universiteti bëhet pjesë çdo vit e Panairit "Work and Study', ndërkohë që organizon evente të shumta për maturantët.<br><br>*Dokumenti: RVB BA administrim biznes*<br>*Dokumenti 115: Guida e Fakultetit të Ekonomise*;<br>*Dokumenti 115.1: Guida studentore DMT*<br>*Dokumenti* 097: *Ditet e informimit te maturantëve.*<br>*Dokumenti 047.3: Vendim i Dekanit mbi Kriteret e pranimit 2024-2025;* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Bazuar në udhëzimin Nr. 17 dt. 30.07.2019, si dhe në përvojën e krijuar në vite, departamenti përcakton kuotat për studentët me aftësi ndryshe, ata që vijnë nga pakicat dhe shtresat në vështirësi.<br>Në përputhje me udhëzimet e MAS, por dhe traditën e krijuar me rregjistrimet vit pas viti, departamenti vlerëson kuotat sipas kategorive të përcaktuara nga Matura Shtetërore, përfshirë dhe studentët që vijnë nga trojet shqiptarë, propozimet kalojnë në dekanat dhe miratohen nga Senati akademik, për t'u përcjellë për fazën e fundit të miratimit tek Bordi Administrimit të IAL-së.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 006: Rregullore per organizimin dhe funksionimin e Departamentit te Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 006.1 Rregullore Njësia Bazë DMT 2022;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti: RVB BA administrim biznes*<br>*Dokumenti 071: Kriteret e propozuara te dhy viteve të fundit 2024-2025;*<br>*Dokumenti 047.3: Vendim i Dekanit mbi Kriteret e pranimit 2024-2025;*<br>*Dokumenti 047.4: Propozim kuotash_2024-2025;*<br>*Dokumenti 047.6: Vendim Dekanati Kuotat e Pranimit 2024-2025* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Universiteti i Tiranës mbështetur në Nenin 8, pika 8 të Statutit të UT garanton realizimin e të drejtave studentët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marxhinalizuara.<br>Këto kuota të veçanta i ofrohen kandidatëve fitues nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja, dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit si dhe të kandidatëve të komunitetit Rom dhe Egjiptjan<br><br>Për t'ju përgjigjur më mirë kërkesave që paraqiten përpara IAL-ve, FE dhe departamentet përgjegjëse për programin e studimit BA në AB janë angazhuar ofrimin e programit dhe në gjuhën gjuhën angleze duke krijuar më shumë oportunitet për studentë të huaj, por dhe studentët shqiptarë e të trojeve.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti: RVB BA administrim biznes*<br>*Dokumenti 071: Kriteret e propozuara te dhy viteve të fundit 2024-2025;*<br>*Dokumenti 047.3: Vendim i Dekanit mbi Kriteret e pranimit 2024-2025;*<br>*Dokumenti 047.4: Propozim kuotash_2024-2025;*<br>*Dokumenti 047.6: Vendim Dekanati Kuotat e Pranimit 2024-2025* |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartën dhe në një sërë aktesh që rrjedhin prej tij, studentët e univesiteteve publike mund të aplikojnë për reduktim apo përjashtim nga tarifa e studimit. Miratimi i kërkesave të studentëve bazohet në procedurat e definuara në Rregulloren e Komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët.<br>Studentët mund të gjejnë informacionin mbi bursat në linkun: https://feut.edu.al/studentet/mundesi-per-bursa/bursa-te-ofruara-nga-shteti<br><br>*Evidenca 143: Bursa te ofruara nga shteti per studentet FE* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard, FEUT vepron në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, dhe të gjitha VKM apo udhëzimet që vit pas viti përditësohen në përputhje me ndryshimet që bëhen në Maturën Shtetërore apo vendimeve në mbështetje të studentëve dhe shkollimit të tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Në Rregulloren e UT dhe në Rregulloren e Programit BA në AB pasqyrohen procedurat e përparimit akademik. Në Rregulloren e Programit të Studimit BAAB përcaktohen elementët e vlerësimit të vazhduar të studentëve dhe pesha që zë provimi ndërmjetëm dhe përfundimtar. Studenti është kalues nëse ai ka mbledhur 50% të pikëve në provimin ndërmjetës dhe atë përfundimtar.<br>Në Rregulloren e UT përcaktohen kriteret e kalimit nga viti në vit, si numri i riprovimeve që studenti ka të drejtë të hyjë. Gjithashtu, në Rregulloren e UT, disa nene i referohen |

| | |
|---|---|
| | procedurës së ndërprerjes së studimeve nisur nga arsyet për ndërprerjen e studimeve, autoriteti që ka të drejtën e miratimit, gjithashtu qartësohet si bëhet përditësimi i dijeve të studentit pasi ai rikthehet për të vijuar studimet.<br>Bazuar në Statutin e UT, Rregulloren e UT, Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet procedura e realizimit të punimit të Diplomës dhe sezonet që student mund ta mbrojë atë. Informimi studentëve për procedurat e përparimit akademik bëhet përmes disa formave: në klasë në ditët e informimit; në WEB e FEUT, në Guidën e FEUT dhe nga çdo pedagog në javën e parë, por dhe më pas në mësim në përputhje me silabuset e lëndëve.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti: RVB BA administrim biznes*<br>*Dokumenti 115: Guida e Fakultetit të Ekonomise*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Një nga përfitimet më të rëndësishme të Procesit të Bolonjës, është mobiliteti studentëve brenda dhe jashtë vendit. UT bazuar dhe në Ligjin Nr 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në Statutin e tij përkatësisht Neni 109 dhe 112 ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe të transferimit të tyre nga një institucion i arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit<br>Në Rregulloren e Universitetit në kapitull 3 të emërtuar "Ekuivalentimi, tranferimet dhe ndryshimi i sistemit të studimeve" përmes një numri nenesh përcaktohen dhe qartësohen: Ekuivalentimi; Lloji i transferimeve; Procedura e Kërkesës, Propozimi dhe Miratimi i Transferimit; Ekuivalentimi.<br>Si rregull, Drejtuesi i departamentit përcakton komisionin e ekuivalentimit i cili shqyrton të gjitha kërkesat që vijnë qoftë për transferimet, programe të dytë studimi apo është një kërkesë ligjore në kuadër të njohjes së diplomave të huaja.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në | Në Rregulloren e Programit të Studimit BAAB, përcaktohen të gjitha modalitetet e vlerësimit të vazhduar, nga detyrat e kursit, |

| | |
|---|---|
| lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | detyrat e shtëpisë, provim i ndërmjetëm dhe provim përfundimtarr, si dhe elemëntë procedurialë që kanë të bëjnë me të drejtën e studentëve për të hyrë në provim dhe për t'u ankimuar në lidhje me rezultatin.<br>Gjithashtu, në silabuset e çdo lëndë jepet mënyra e kontrollit të dijeve dhe si rregull në orën e parë të çdo lëndë pedagogu qartëson studentët për mënyrën e vlerësimit. Natyrisht, eksperienca është e tillë që dhe në periudhat ndërmjetëse që lidhen me afatet e dorëzimit të detyrave apo para provimeve studentët rikujtohen për rregullat, procedurat, kufizimet dhe të drejtat e tyre. Përtej punës së bërë nga pedagogët, informacioni do të ishte më lehtë i aksesueshëm nëse Fakulteti do të kishte një sistem LMS, ku në çdo lëndë do të kishin mundësi të kishin silabusin dhe rregulloren e programit, si kalendar të të gjitha veprimtarive brenda lëndës.<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti: RVB BA*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Në Rregulloren e Programit BA në AB përcaktohet që diplomimi bëhet përmes mikrotezës që ka karakter kërkimor dhe aplikativ, mbështetur në Udhëzuesin për Temën e Diplomës.<br>Studenti ka të drejtë të propozojë udhëheqësin e tij, miratimi bëhet nga drejtuesi i departamentit. Vlerësimi i mikrotezës bëhet nga udhëheqësi dhe anëtarët e komisionit të diplomimit. Departamenti ka përcaktuar gjithashtu një template (format) të punimit të mikrotezës. Si rregull mbrotja e diplomës është e hapur dhe pas prezantimit anëtarët e Komisionit dhe të pranishëm të tjerë gëzojnë të drejtën e bërjes së pyetjeve.<br>Gjatë vizitës në institucion një nga diskutimet me stafin e departamentit ishte si sigurohet origjinaliteti i mikrotezave. U dakordësuam që kjo mbetet një çështje shumë e diskutueshme, ku përtej aspekteve proceduriale dhe të integritetit të pedagogut, e rëndësishme është kultura e institucionale në këtë drejtim.<br><br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 114: Udhëzuesi i Temës së Diplomës*<br>*Dokumenti 015.1_Modeli i Diplomes Shqip*<br>*Dokumenti 015.2: Modeli i Diplomes Administrim Biznesi-Anglisht;*<br>*Dokumenti 080: Format Mikroteze mbi Diplomen Bachelor;* |

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 112.4: Formular Vlerësimi - Temë Diplome për Ciklin e Parë Bachelor;*<br>*Dokumenti 015.3 Suplement i Diplomes Bachelor Adm Biznesi;*<br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 141: Hapat e nevojshme mbi lidhen me nraktiken dhe perzgjedhjen e pedagogut udheheqes dhe proceset qe lidhen me praktiken dhe diplomen;*<br>*Dokumenti 142: Komisione per mbrojtje diplome;* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Ka tre rrugë të informimit të aplikantëve për studimet BA në AB:<br>- e para përmes WEB të UT, bazuar në politika të caktuara të marketingut që universiteti ka të përcaktuara në Statutin e tij.<br>- e dyta, çdo vit, në fund të semestrit të dytë Fakulteti realizon takime te hapura me maturantët, në mënyrë që t'i informojë ata mbi mundesite dhe oportunitetet e studimit në FE. Një element mbështetës për Departamenti i Menaxhimit ka të formulur një dokument mbi "Politikat e marketingut të programit të studimit" ku identifikohen disa rrugë nga bursat, tek panairet, këshillimi i karrierës, konkurset, mbështetja e sipërmarrjes së studentëve.<br>- Rruga e tretë është përmes Qendra e Karrierës, e cila po strukturohet dhe ka marrë një vëmendje më të rritur në institucion, ku me ristrukturimin e godinës ka zënë një vend të dukshëm në hyrje dhe ka një specialiste të dedikuar në raportet me studentët.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti UT*<br>*Dokumenti 051: Politikat e marketingut të programit të studimit*<br>*Dokumenti 097: Ditet e informimit te maturantëve* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se FEUT ka një veprimtari intensive në funksion të studentëve në lidhje me dhënien e informacionit mbi programin e studimit, përmes formave që sot aksesohen më shumë nga të rinjtë.*<br>*Gjithashtu dhe brenda fakultetit janë ndërtuar mekanizmat që informacioni për çdo fazë të jetës akademike të shkojë në mënyrë sa më të shpejtë tek studentët. Media sociale, faqja e internetit dhe platforma Pitagora e mundësojnë këtë gjë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3** |
|---|

| **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Studentët kanë disa rrugë për t'u informuar për përmbajtjen e programit BA në AB. Fillimisht është WEB e fakultetit dhe Guida e Fakultetit Ekonomik ku studentët gjejnë informacionin paraprak dhe bazë.<br>Dosja e plotë e programit të studimit është një dokument i formuluar me seriozitet, në të cilin gjendet çdo informacion i nevojshëm në lidhje me programin BA në AB. Programi përmban 180 kredite, që ndahen mes lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndëve më zgjedhje; praktikën mësimore dhe detyrimin përmbyllës të diplomës.<br>Mësimi organizohet në 6 semestra, çdo semestër zgjat 15 javë. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, studentët gëzojnë të drejtën të përfundojnë studimin në BA në AB në një afat ligjor që është dyfishi i periudhës së studimit, kuptuar deri në 6 vite nga momenti i nisjes, përjashtim nga ky rregull bëhet në rastin kur studenti pezullon studimet e tij për një afat të caktuar kohor për rrethana të caktuara në jetën e tij<br>Sekretaria mësimore dhe zyra e informacionit mbështet studentët gjatë gjithë periudhes së shkollimit, nga regjistrimi në diplomim. Gjithashtu koordinatorët e programit të studimit (dy drejtuesit e departamenteve përgjegjëse) si dhe koordinatorët e studentëve janë në kontakt të vazhdueshëm me studentët, për çdo, për çdo nevojë që ato kanë gjithë periudhës së studimeve.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti UT*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij; Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht);*<br>*Dokumenti 123: Struktura e Vitit Akademik Bachelor në Administrim Biznes;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 036.1: Vendim per per emerimin e koordinatorit te studenteve;*<br>*Dokumenti 036.2: Detyrat e kordinatorit akademik te studenteve;*<br>*Dokumenti 036.3: Shkresa e caktimit te koordinatorit te studenteve per vitin Dokumenti 036.4: Caktohen Kordinatorët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznes;* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Dosja e plotë e programit të studimit u përcjell studentëve çdo informacion i nevojshëm në lidhje me programin BA në AB. Programi përmban 180 kredite, që ndahen mes lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndëve më zgjedhje; praktikën mësimore dhe detyrimin përmbyllës të diplomës. Mësimi organizohet në 3 vite akademike, 6 semestra, semestri fundit përmban dhe praktikën dhe diplomën.<br>Një burim tjetër i rëndësishëm informacioni është silabusi i lëndëve i cili qartëson llojin e lëndës, numrin e krediteve, semestrin në të cilin zhvillohet, mënyrën e vlerësimit të njohurive, detyrimet e lëndës, frekuentimin.<br>Departamentet përgjegjëse bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit përcaktojnë dhe koordinatorët e programit, i cili në thelbin e veprimtarisë së tij është një ndërlidhës i rëndësishëm i studentit me departamentin dhe gjithë procesin akademik. Për programin e studimit në process vlerësimi koordinatorë janë dy drejtuesit e departamenteve të Menxhimit dhe Marketingut e Turizmit. Në përputhje me Statutin e UT dhe Rregulloren e UT, Sekretaria mësimore e studimeve bachelor dhe Zyra e Informacionit suportojnë studentët për të gjitha nevojat dhe kërkesat e tyre.<br><br>***Vlen të ritheksohet që jetojmë në epokën e digjitalizimit dhe për FEUT do të duhej që komunikimi me studentët krahas aspektit njerëzor që mbetet me vlerë, të kalojnë në platforma. WEB është një nga mundësitë që fakulteti e përdor, por një Learning Management System do të shënonte një hap cilësor në raportet e përditshme student-pedagog-sekretari- drejtim FEUT.***<br><br>*Dokumenti 115: Guida e Fakultetit të Ekonomise*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 019: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (shqip);*<br>*Dokumenti 019.1: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (anglisht* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për | Nësë flitet për pikat e forta të FEUT janë cilësia dhe reputacioni i stafit akademik si dhe cilësia e studentëve, për rrjedhojë kanali më i rëndësishëm për punësimin e studentëve mbetet rekomandimi i tyre nga pedagogët, për shkak të netëorkut të tyre. |

| | |
|---|---|
| orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Në FEUT, Qendra e Karrierës përbën një bërthamë të kontaktit të studentëve me tregun e punës, dhe ekzistojnë të gjitha premisat që ajo të rritet e bëhet më dinamike.<br>Në WEB e FEUT, botohen një sërë publikimesh që kanë lidhje me konkurse, intershipe, punësime etj në ndihmë dhe në shërbim të studentëve. Duhet theksuar që studentët e programit BA në AB përfshihen në aktivitete që organizohen nga departamenti, fakulteti por dhe UT.<br><br>*Dokumenti 115: Guida e Fakultetit të Ekonomise*<br>*Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025*<br>*Dokumenti 017: Studim per tregun e punes pas daljes se studenteve Departamenti i Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 007.2 Studime të Tregut të Puneë Departamenti Marketing -Turizem 2020-2022;*<br>*Dokumenti 012: Udhëzim mbi funksionimin e zyrës se karrierës FEUT 2025; Dokumenti 012.1: Informacion mbi Qendren Karrieres;*<br>*Dokumenti 012.2: Aktivitet-Njoftimet - Zyra e Karrierës 2021 -2025;*<br>*Dokumenti 012.3: Raport Dita e Karrieres 2025;* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Informacioni në funksion të studentëve vihet në shërbim të studentëve kryesisht përmes kanaleve të mëposhtme të komunikimit:<br>- WEB i UT;<br>- WEB i FEUT;<br>- Pedagogëve;<br>- stendës së FEUT në hyrje të fakultetit;<br>- koordinatorëve të programit BA në AB;<br>- sekretarisë mësimore.<br>- zyrës së informacionit<br>*Ashtu siç theksuam dhe më lart, përtej kulturës së institucionit, që mbetet e rëndësishme, FEUT duhet të qaset tek sistemet digjitale të menaxhimit të informacionit, tashmë kjo është një nevojë urgjente dhe institucioni duhet të veprojë sa më shpejt.*<br><br>*Dokumenti: 088: Manual sistemi e-studentet;*<br>*Dokumenti: 077: Rregullore per funksionimin e sistemit informatik:*<br>*Dokumenti: 042.1: Të dhëna të plota për infrastrukturën të programit të stndimit 2022-2023*<br>*Dokumenti: 042.2: Lista e ambienteve FE_2022-2023;*<br>*Dokumenti: 042.3: Lista e ambienteve FE_2023-2024;* |

<table>
<tr><td>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</td><td colspan="4">Përmes sistemit e –student, studentët aksesojnë një pjesë të të dhënave të tyre.<br>Siç theksojmë dhe më lart një sistemi i plotë i integruar që lidh studentët- pedagogët- sekratarinë- zyrat e tjera të institucionit ende nuk është funksional në UT.<br><br>Digjitalizmi i IAL-ve publike shqiptare mbetet nje nga shtyllat e zhvillimit strategjik të tyre dhe natyrisht këtu UT duhet të marrë eksperiencë nga universitet perëndimore.</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ vlerëson që përtej gjithë përpjekjeve të FEUT dhe departamenteve përgjegjëse për programin e studimit si dhe kulturës së fortë institucionale të FEUT në shërbim të informimit të studentëve, FEUT duhet të qaset tek sistemet digjitale të menaxhimit të informacionit, Learning Management System do të shënonte një hap cilësor në raportet e përditshme student-pedagog-sekretari- drejtim FEUT, ka nevojë për më shumë qasje që bazohet në digjitalizim.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi V.4<br>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</td><td>Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e U, Sekretaria Mësimore, funksionon në bazë të të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe rregullores së sekretarisë mësimore. Në Sekretarinë Mësimore mbahen të gjitha statistikat në lidhje me numrin e studentëve: të rregjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, regjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS.<br><br>Dokumenti 014: Dosja e plotë e programit të studimit<br>Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;<br>Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;<br>Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010<br>Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;<br>Dokumenti 009: Rregullore e Sekretarisë mësimore FEUT 2025;</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td></td><td>Dokumenti 027: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, ecurinë, dipl diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</td><td>FEUT mbledh dhe administron statistika vjetore të detajuara për ciklin e plotë të ndjekjes së studentëve në programin e studimit, duke filluar nga regjistrimi deri në diplomim për programin e studimit Bachelor në AB.<br><br>Të dhënat regjistrohen dhe përpunohen nga njësitë përgjegjëse si Zyra e Regjistrimit, Sekretaria mësimore dhe zyra e Kujdesit ndaj Studentit, dhe janë të aksesueshme për strukturat akademike, Dekanit, Drejtuesit e departamenteve, për vlerësimin e performancës së programit dhe për hartimin e masave për përmirësimin e mbajtjes së studentëve. Përmes analizës së rregullt të këtyre statistikave, institucioni synon të identifikojë faktorët që ndikojnë në vazhdimësinë apo ndërprerjen e studimeve, si dhe të ofrojë mbështetje të synuar për kategoritë në rrezik.<br><br><table><tr><th colspan="2">Të regjistruar</th></tr><tr><td>2022-2023:</td><td>420 studentë</td></tr><tr><td>2023-2024:</td><td>408 studentë</td></tr><tr><td>2024-2025:</td><td>416 studentë</td></tr></table><br>Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;<br><br>Dokumenti 009: Rregullore e Sekretarisë mësimore FEUT 2025;</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</td><td>Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në sekretarinë e programeve master. Dosjet e ecurisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për cdo vit akademik, rregjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që ju kërkua stafit u vendos në dispozicion.<br>UT përdor sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve E-Student [https:/le student.unitir.edu.al/e_student_ut], që funksionon me akses vetëm në marrjen e informacionit për studentët, ndërkohë pedagogët aksesojnë të dhënat e lëndëve të tyre, ndërkohë sekretaria mësimore hedh të dhënat, verifikon dhe prodhon proces verbale e material të tjera. Elementët e sigurisë përcaktojnë dhe aksesin e punonjësve të sekretarisë, pedagogëve dhe studentëve.<br><br>Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;<br>Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar;*<br>*Dokumenti 009: Rregullore e Sekretarisë mësimore FEUT 2025;*<br>*Dokumenti 027: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, ecurinë, dipl diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare*<br>*Dokumenti RVB*<br>*Dokumenti 046: Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit _ Pedagog*<br>*Dokumenti 046.1: Udhëzues për përdorimin e struktures së teknologjise së*<br>*informacionit_student;*<br>*Dokumenti 046.3: Upgrade i aplikimit software e-Student UT;*<br>*Dokumenti 088: Manual sistemi e-studentët* |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, sekretaria mësimore si pjesë e njësisë së Administratës të FEUT, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i rregjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës.<br>Gjatë vizitës në sekretarinë e studimeve master, dosjet fizike dhe "dosjet elektronike", rregjistrat, proces-verbalet, rregjistri themeltar dhe çdo dokument tjetër që është nën përgjegjësinë e zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mjaft mirë të sistemuara.<br>Ndërtimi dhe funksionalizimi i sistemit digjital të menaxhimit të informacionit jo vetëm për sekretarinë, por dhe të gjithë sistemin e FEUT mbetet një sfidë e qenësishme për të.<br><br>*Dokumenti RVB*<br>*Dokumenti 009: Rregullore e Sekretarisë mësimore FEUT 2025;*<br>*Dokumenti 046: Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit _ Pedagog*<br>*Dokumenti 046.1: Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së*<br>*informacionit_student;*<br>*Dokumenti 046.3: Upgrade i aplikimit software e-Student UT;*<br>*Dokumenti 088: Manual sistemi e-studentët* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në | Fakulteti Ekonomik i UT, bazuar në udhëzimet e MAS harton raportet vjetore. Raportet vjetore kanë një format standard dhe një nga rubrikat i referohet të dhënave të studentëve për çdo program studimi. |

| | |
|---|---|
| hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Një Rapor tjetër i rëndësishëm është dhe analiza vjetore e punës së departamenteve, në të cilën gjenden të dhëna mbi kalueshmërinë dhe mesataren e vlerësimit për çdo lëndë të departamentit, lëndët e BAAB përfshirë. Një raport me vlerë në tërësinë e dokumentacionit të paraqitur është ai i gjurmimit të studentëve pas diplomimit, të dhënat e të cilit duhet të shërbëjnë dhe për të përditësuar programin.<br><br>*Dokumenti 038: Analiza vjetore periodike e departamentit menaxhimit*<br>*Dokumenti 038.1: Analiza vjetore e departamentit* te Marketing Turizem rizem 2019-2022;<br>*Dokumenti 038.2_Analizë vjetore e Departamentit te Manaxhimit 2020-2021*; *Dokumenti 038.3_Analiza Vjetore Departamenti i Manaxhimit 2021-2022;*<br>*Dokumenti 101.1_Raporti vjetor FEUT 2021-2022;*<br>*Dokumenti 101.2_Raporti vjetor FEUT 2022-2023;*<br>*Dokumenti 101.3_Raporti vjetor FEUT 2023-2024;*<br>*Dokumenti 017: Studimi periodik për tregun epunës, pas daljes së studentëve 2025;*<br>*Dokumenti 017.1 Studim per tregun e punes pas daljes se studenteve Departamenti i Manaxhimit 2022;*<br>*Dokumenti 017.2 Studime të Tregut te Punes Departamenti Marketing -Turizem 2020-2022.* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson që FEUT ka një sistem të ngritur e funksional që përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme mbi ecurinë e studentëve, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre, si dhe analizon të gjithë veprimtarinë e saj në nivel njësie bazë dhe kryesore përmes raporteve periodike.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet | Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. Kreu IX i Statutit të UT i dedikohet studentëve, në Nenin 125- Të drejtat e studentëve- përcaktohet që studentët |

| | |
|---|---|
| vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | gjatë periudhës së studimeve kanë të drejtë të përfaqësohen në organet e UT, me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe.<br><br>Bazuar në Nenin 30 të Statutit të UT, në Senatin Akademik bëjnë pjesë dhe studentët, përfaqësuesit e të cilëve zgjidhen përmes votimit të studentëve. Bazuar po në Statut - Neni 32, nga 35 anëtarë që ka senati akademik 4 prej tyre janë studentë.<br><br>Gjithashtu, studentët janë pjesë e:<br><br>- komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë;<br><br>- komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarive dhe marrëdhënieve me studentët;<br><br>- komisionit të kurrikulave.<br><br>- komisionit të etikës<br><br>- grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe grupeve të tjera ad hoc qe mund të ngrihen në nivel njësie kryesore apo bazë.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br><br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br><br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar*<br><br>*Dokumenti 100_ Rregullore per zgjedhjet e keshillave studentore ne UT;*<br><br>*Dokumenti 053_Lista Emerimeve GVB ne FEUT 2025;*<br><br>*Dokumenti 040.4_Perberja e Komisionit te NJSBC 2024-2025 Vendim Nr 6, datë 25.03.2025.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret dhe organet e institucionit si: Rregullorja e UT; Rregullore e Komisionit të Kurrikulave; Rregullore për Zgjedhjen e Këshillit Studentor; NJSBC në rang fakulteti, etj sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimarrje.<br>Pjesëmarrja e studentëve në Komisionin e Kurrikulave, në Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, në Senat në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimin e programeve, BA në AB përfshirë.<br>Studentët përfaqësohen në Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, i cili garanton bashkëpunimin midis organeve drejtuese të Universitetit dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë |

| | |
|---|---|
| | Pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të lëndës, që krijon mundësine e analizave të mëtejshme në terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar*<br>*Dokumenti 100_ Rregullore per zgjedhjet e keshillave studentore ne UT;*<br>*Dokumenti 053_Lista Emerimeve GVB ne FEUT 2025;*<br>*Dokumenti 040.4_Perberja e Komisionit te NJSBC 2024-2025 Vendim Nr 6, date 25.03.2025.*<br>*Dokumenti RVB*<br>*Dokumenti 013: Rregullore e komisionit te perhershem të Kurrikulës ne UT 2020; Dokumenti 118: Për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, në UT*<br>*Dokumenti 040_Vlerësimi i lëndës nga studenti;* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Studentët përfshihen në mënyrë direkte dhe indirekte në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor dhe programit të studimit. Kështu, ata bëjnë vlerësimin periodik të mësimdhënies së pedagogëve, ndërveprojnë gjatë gjithë periudhës së studimeve me drejtuesit e departamentit dhe fakultetit, ndërveprojnë dhe orientojnë pakënaqësitë apo sugjerimet e tyre përmes pjesëmarrjes në shumë komisione e organe, dhe natyrisht sjellin zërin e tyre përmes Këshillin Studentor.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit të Tiranës 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar*<br>*Dokumenti 100_ Rregullore për zgjedhjet e këshillave studentore në UT;*<br>*Dokumenti 053_Lista Emërimeve GVB ne FEUT 2025;*<br>*Dokumenti 040.4 _Përbërja e Komisionit te NJSBC 2024-2025 Vendim Nr 6, datë 25.03.2025.*<br>*Dokumenti RVB*<br>*Dokumenti 013: Rregullore e komisionit të përhershëm të Kurrikulës në UT 2020; Dokumenti 118: Për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, në UT*<br>*Dokumenti 040: Vlerësimi i lëndës nga studenti;* |

Adresa: Blloku Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë
E-mail: info@ascal.al
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 041.1: Pyetësori i personelit akademik Universitetit te Tiranes.* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Studentët kanë të drejtë të kërkojnë shpjegim për mënyrën e vlerësimit të dijeve në të gjitha format e kontrollit të dijes, nga pedagogu i tyre. Në rastin kur shpjegimi i pedagogut nuk është shterues për arsyet që studenti mbron, ai gëzon të drejtën e ankimimit në Sekretarinë Mësimore. Në Rregulloren e Programit të Studimit qartësohen procedurat dhe hapat në rast të pranimit apo jo të ankesës nga pedagogu.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 005: Rregullore e UT 2010*<br>*Dokumenti 005.1: Rregullore_UT 2022 e ndryshuar*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson që nga pikëpamja e zbatimit të ligjeve dhe akteve rregullatore ky standard përmbushet. Pjesë e rëndësishme është pjesëmarrja e studentëve në vlerësimin e procesit akademik dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të lëndës, që krijon mundësinë e analizave të mëtejshme në terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | FEUT bën përpjekje për të ecur me hapin e kohës në lidhje me informimin e studentëve për procesin mësimor, dhe aktivitetet e ndryshme që ndodhin.<br><br>Informacioni në funksion të studentëve vihet në shërbim të tyre kryesisht përmes kanaleve të mëposhtme të komunikimit: faqja e internetit e UT; faqja e internetit e FEUT; Pedagogëve; stendës së FEUT në hyrje të fakultetit; koordinatorëve të programit BA në AB; sekretarisë mësimore, zyrës së informacionit dhe media sociale. Gjithashtu, pedagogët në orët e mësimit informojnë studentët mbi elementët bazë të procesit |

| | |
|---|---|
| | mësimor, detyrimet e studentëve, format e kontrollit të dijes, frekuentimin etj.<br><br>Qendra e karrierës mbështet studentët përgjatë gjithë ciklit të studimeve, duke ofruar informacione për eventet, mundësitë për punësim dhe intershipe etj.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 047: Të dhëna nga Faqja zyrtare e internetit;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti; 008 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e NJSBC UT 2022; Dokumenti 040.1: Paketa e intrumenteve te cilesise UT;*<br>*Dokumenti 008.2: UT Manual i sigurimit të cilesise;*<br>*Dokumenti 012.1: Informacion mbi Qendren e Karrieres;*<br>*Dokumenti 012.2: Aktivitet-Njoftimet - Zyra e Karrierës 2021 -2025;*<br>*Dokumenti 123: Struktura e Vitit Akademik Bachelor në Administrim Biznes; Dokumenti 124: Qendra Virtuale e Trajnimit ne UT Vendim-nr.48.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Brenda fakultetit, Zyra e Informimit të Studentëve, Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Zyra IT, koordinatori i programit - drejtuesi i departamentit dhe stafi i tij ndihmojnë studentët për qartësimin e elementëve të ndryshëm në procesin nga rregjistrimi i tyre deri në marrjen e diplomës<br>Për ndjekjen e ecurisë mësimore, në shërbim të studentëve është sistemi e-student, por dhe shumë informacione që në mënyrë të vazhduar merren përmes komunikimit ditë pas pas dite me sekretarinë dhe departamentin. Gjatë vizitës në institucion, studentët, stafi, drejtuesit dhe zyrat e ndryshme vlerësonin efekshmërinë e një kanali komunikimi përkundrejt një tjetri.<br>Pedagogët gjithashtu komunikojnë me studentët dhe përmes sistemit MS Teams duke dërguar materialet, dhe duke ju përgjigjur kërkesave të tyre përmes platformës.<br>Një nga kanalet efektive të komunikimit të FEUT me studentët është WEB i fakultetit, në të cilin ata informohen për elementë të shumtë të procesit akademik, por dhe për shumë mundësi e procese të tjera nga konkurset, konferencat, mundësitë për intership, punësim, bursa Erasmus, etj.<br><br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 047: Të dhëna nga Faqja zyrtare e internetit;*<br>*Dokumenti 007: Rregullore e programeve bachelor 2025;*<br>*Dokumenti 012.1: Informacion mbi Qendren e Karrieres;* |

Adresa: Blloku Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,
Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | *Dokumenti 012.2: Aktivitet-Njoftimet - Zyra e Karrierës 2021 -2025*<br>*Dokumenti 035: Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimeve;*<br>*Dokumenti 032_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpuuese, për programin e studimit dhe për praktikën projesionale 2025.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Në takimin në institucion me stafin e angazhuar në program, evidentuam që pedagogët e departamentit për shkak të reputacionit të tyre janë këshilluesit më profesionistë të karrierës së studentëve të tyre dhe kjo përbën një vlerë të shtuar për institucionin dhe studentët, në atë çka ata mund të përfitojnë gjatë viteve të studimit.<br>Në FEUT, Qendra e Karrierës është e alokuar në hollin hyrës, duke i dhënë mundësinë studentëve të aksesojnë dhe ndërveprojmë me specialisten e saj. Qendra e Karrierës është një strukturë mbështetëse e rëndësishme për studentët e UT, që ofron orientim profesional, aktivitete zhvilluese dhe mundësi reale për integrim në tregun e punës. Giate vitit akademik në tregun e punës. Gjatë vitit akademik, Zyra e Karrierës organizon disa aktivitete kryesore si: Të njohim fakultetin - orientim për studentët e Rinj; Shkolla Verore/Dimërore; Kampionati i Debatit; Panairi i Karrierës; Leksione të Hapura dhe Info Days<br><br>*Dokumenti 012.1: Informacion mbi Qendren e Karrieres;*<br>*Dokumenti 012.2: Aktivitet-Njoftimet - Zyra e Karrierës 2021 -2025*<br>*Dokumenti 035: Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimeve;*<br>*Dokumenti 032_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpuuese, për programin e studimit dhe për praktikën projesionale 2025*<br>*Dokumenti 047_Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB;*<br>*Dokumenti 012.3_Raport Dita e Karrieres 2025*<br>*Dokumenti 017: Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve 2025;*<br>*Dokumenti 017.1: Studim per tregun e punes pas daljes se studenteve Departamenti i Manaxhimit 2022* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna | Qendra e Karrierës dhe Departamentet mbledhin në vijueshmëri informacione mbi studentët e diplumar, punësimin e tyre, DM dhe DMT luajnë vetë një rol të rëndësishëm në ndjekjen e studentëve të BA pas diplomimit, këtij qëllimi i |

| | |
|---|---|
| mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | shërben dhe ngritja e një grupi punë nga departamentet përgjegjëse për programin e studimit.<br><br>*<u>Sugjerim</u> tjetër është organizimi i aktiviteteve të Rrjetit Alumni, i cili në rastin e programit që akreditohet do të ishte dhe një histori suksesi.*<br><br>*Dokumenti 012.1: Informacion mbi Qendren e Karrieres;*<br>*Dokumenti 012.2: Aktivitet-Njoftimet - Zyra e Karrierës 2021 -2025*<br>*Dokumenti 047_Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB;*<br>*Dokumenti 012.3_Raport Dita e Karrieres 2025*<br>*Dokumenti 017: Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve 2025;*<br>*Dokumenti 017.1: Studim per tregun e punes pas daljes se studenteve Departamenti i Manaxhimit 2022*<br>*Dokumenti 061: Alumni_FE 2025.* |
| **Konkluzione** | *GVJ evidenton që në lidhje me këtë standard në FEUT ka një angazhim për të vendosur studentin në qendër dhe për t'i shërbyer më së miri, në çdo fazë të procesit dhe formimit të tij, por ka ende elementë për të përmirësuar veçanërisht në lidhje me trajtimin e ankesave dhe rrjetin alumni është organizimi i aktiviteteve të Rrjetit Alumni.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme | Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e FEUT, GVJ konstatoi se UTi ka strukturat dhe procedurat të mirëpërcaktuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. Këto struktura janë në nivel UT_je |

| | |
|---|---|
| dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | e cila është struktura e Sigurimit të Brendshëm SBC, struktura e FEUT Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBC dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UNIKO.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 002: Statuti i Universitetit te Tiranes 2018;*<br>*Dokumenti 003: Strategjia e zhvillimit të UT 2023-2028;*<br>*Dokumenti 008.1: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë në UT;*<br>*Dokumenti; 008 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e NJSBC UT 2022; Dokumenti 040.1: Paketa e intrumenteve te cilesise UT;*<br>*Dokumenti 008.2: UT Manual i sigurimit të cilesise;*<br>*Dokumenti 008.3: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët, konstatoi se UT monitoron në vazhdimësi proçeset, veprimtaritë, burimet njerëzore dhe kontekstin në të cilin realizohet misioni i tij si një qendër arsimore dhe kërkimore. Treguesit kryesorë të performancës maten, përmes hartimit të raportit të vetëvlerësimit, monitorimit të vazhdueshëm të dokumentacionit, rritjes së ndërgjegjësimit të rolit të stafit dhe studentëve në sigurimin e cilësisë, përmes anketave dhe pyetësorëve, përcaktimit të rekomandimeve për përmirësim dhe ndjekjes në vijimësi të masave të ndërmarra. Vlerësimi i stafit akademik për cilësinë e mësimdhënies kryhet nëpërmjet pyetësorit të përgjithshëm i cili zhvillohet nga NjSBC në bashkëpunim me këshillin studentor. Performanca e stafit akademik vlerësohet në kuadër të arritjeve në fushën akademike dhe kërkimore të gjithsecilit nëpërmjet analizave në përfundim të një moduli, si dhe gjatë analizave vjetore të departamentit sipas modelit të miratuar në manualin e cilësisë.<br>Gjithashtu në vitin akademik 2022-2023 më saktësisht në Shtator 2022 IQE (Instituti për Cilësi në Arsim) në bashkëpunim me UT, ka zhvilluar një pyetësor me studentët e Universitetit të Tiranës. Me qëllim që Institucionet drejtuese të UT_së krahas pyetësorëve që realizojnë vetë, të konsiderojnë, adresojnë por edhe të vlerësojnë edhe pyetësorët e realizuara nga Institucione jashtë UT_së në bashkëpunim, me qëllim ruajtjen dhe rritjen e cilësisë.<br><br>*Dokumenti: RVB;* |

| | |
|---|---|
| | *Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 037.2: Rezultatet e pyetësorit të studentëve UT final pdf;*<br>*Dokumenti 040.12: Raporti mbi aplikimin e instrumentave të cilësisë NJSBC 2022-2023;*<br>*Dokumenti 003: Strategjia e zhvillimit të UT 2023-2028;*<br>*Dokumenti 008.1: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë në UT;*<br>*Dokumenti; 008 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e NJSBC UT 2022; Dokumenti 040.1: Paketa e intrumenteve te cilesise UT;*<br>*Dokumenti 008.2: UT Manual i sigurimit të cilesise;*<br>*Dokumenti 008.3: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UT u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënes; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në FEUT.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 040.12: Raporti mbi aplikimin e instrumentave të cilësisë NJSBC 2022-2023;*<br>*Dokumenti 003: Strategjia e zhvillimit të UT 2023-2028;*<br>*Dokumenti 008.1: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë në UT;*<br>*Dokumenti; 008 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e NJSBC UT 2022; Dokumenti 040.1: Paketa e intrumenteve te cilesise UT;*<br>*Dokumenti 008.2: UT Manual i sigurimit të cilesise;*<br>*Dokumenti 008.3: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | GVJ konstatoi se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UT. GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve janë diskutuar në mbledhjet e Dekanateve ose në departamente; synimi është nxitja e diskutimit në lidhje me nevojën për përmirësimin e kurrikulës, metodave të mësimdhënies apo infrastrukturës në të cilën ajo zhvillohet. Në fund të çdo viti, rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave |

| | |
|---|---|
| | vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve.<br><br>*Dokumenti: RVB;*<br>*Vizita në institucion;*<br>*Dokumenti 038.1: Analizë vjetore e Departamentit të Marketing Turizmit;*<br>*Dokumenti 040.12: Raporti mbi aplikimin e instrumentave të cilësisë NJSBC 2022-2023;*<br>*Dokumenti 008.1: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë në UT;*<br>*Dokumenti; 008 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e NJSBC UT 2022; Dokumenti 040.1: Paketa e intrumenteve te cilesise UT;*<br>*Dokumenti 008.2: UT Manual i sigurimit të cilesise;*<br>*Dokumenti 008.3: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;* |
